# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7335 E premte 27 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga JULIAN ZYLA

## A e njeh kryeministri rregullën që shkeli me gazetarët?



Pas komenteve të kryeministrit Rama mbi pyetjet dhe punën e gazetarëve, një mik më shkroi: "E ndoqe intervistën e Ramës sot jashtë ...

Vijon në faqen 20

Opinioni i Ditës

Nga RIGELS LENJA

## Pse ripajtimi gjermano-polak është ndër më unikët



Për herë të parë këtë vit, në Krzyzowa dhe Wrocław të Polonisë u organizua një seminar ndërkombëtar në bashkëpunim të institucione të diplomacisë ...

Vijon në faqen 21

INTERVISTA/ DREJTORESHA E INAS: SI FUNKSIONON PER SHQIPTARET QE KANE PUNUAR NE ITALI

# "PENSIONET E PLEQERISE, SI VERIFIKOHEN KONTRIBUTET"

Beskida Aliaj: Kriteret e dokumentet që duhet të plotësoni. Kreu i ISSH, Astrit Hado: Ndryshon procedura për dokumentet e pensionit





(Në foto) Beskida Aliaj, drejtuese e Patronatit INAS Albania. Astrit Hado, drejtor i Sigurimeve Shoqërore

Në faqet 8-9



Prokurorët "zbarkojnë" në banesën e Saimir Tahirit

# Kontroll shtëpisë së ish-ministrit, oficerët marrin bizhutë e gruas

Përgjimet e italianëve, Habilaj: Byzylykët bënin 18 mijë euro, por pagova vetëm 9 mijë

Pas autorizimit të mazhorancës parlamentare për mosarrestimin e Tahirit, por hetimin e tij, 4 oficerë kanë "zbarkuar" me mjetet e tyre në shtëpinë e ish-ministrit të Brendshëm. Ka qenë ora rreth 14:00 kur ata trokitën në derën e tij, ndërkaq që prezent veç Saimir...

Në faqen 2

GJYQESORI

## Presidenti Meta: Zhvillimi ekonomik, i lidhur ngushtë me drejtësinë

Në faqen 4

FLET BLEDAR ARA

## Prindërit "luftë" për kujdestarinë, babai i 7-vjeçarit: E ëma e braktisi për letra

Në faqen 11

JA ÇFARE THANE

## Presidenti e ministri i Jashtëm grek, me dy qëndrime të ndryshme për Tiranën

Në faqen 5

UDHEZIMI

## Masteri shkencor e profesional, ja lista me fituesit te Bujqësori

Në faqet 17-19

ZBARDHET SKENA E KRIMIT NE GJIROKASTER



## Vrasja e dyfishtë për pronën, nëna e muzikantit i dhuroi 2 m tokë autorit

Në faqen 7

Përplasje për qëndrimin e ambasadorit të SHBA. Rama: Faleminderit Don! Basha: Je i dëshpëruar

# Lu: "Tahiri", drejtësi. Askush s'është mbi ligjin

*"Në komunizëm burgoseshin të pafajshëm. 27 vjet krime nga të majtë e të djathtë"*

Nga VALENTINA MADANI

Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, theu dje heshtjen, duke u përfshirë në debatin e fortë të çështjes "Tahiri". Pa tone kritike, por me mesazhe të qarta dhe të drejtpërdrejta, diplomati amerikan u përfshi dje në ato



që ai i quajti "polemika rreth ish-ministrit të Brendshëm", duke bërë kontrastin para dhe pas diktaturës në Shqipëri dhe gjyqeve në kohën e Enverit. Ambasadori Lu rikthehet pas në kohë, duke kujtuar periudhën e komunizmit, ku sipas tij, ...

Në faqet 2-3

# ÇËSHTJA "TAHIRI"
## REAGIMET

### Katër oficerë kontrollojnë shtëpinë e ish-ministrit

# Përgjimet, merren për analizim bizhuteritë e gruas së Tahirit

Pas autorizimit të mazhorancës parlamentare për mosarrestimin e Tahirit, por hetimin e tij, 4 oficerë kanë zbarkuar me mjetet e tyre në shtëpinë e ish-ministrit të Brendshëm. Ka qenë ora rreth 14:00 kur ata trokitën në derën e tij, ndërkaq që prezent veç Saimir Tahirit ishte dhe avokati i tij, Maks Haxhia. Kontrolli ka vijuar për rreth 1 orë, ndërsa oficerët kanë heshtur duke mos nxjerrë asnjë detaj nga puna e tyre. Sipas burimeve mësohet se



ata kanë marrë nga shtëpia e ish-ministrit disa bizhuteri të bashkëshortes së tij, për të verifikuar nëse janë ato që përmenden në dosjen e Habilajve ku dy shokët flasin se i kanë dhuruar byzylyk me vlerë 9 mijë euro. Në dosjen me 416 faqe të prokurorisë italiane për grupin e Habilajve, ku del disa herë emri i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri flitet dhe për dhuratat që ata thuhet se i kanë bërë nënës dhe gruas së ministrit Saimir Tahiri.

**PERGJIMI**

"Moisiu futet në makinë dhe i tregon Sabit se kishte marrë dy byzylykë, njërin për nusen e Saimirit dhe tjetrin për nënën e tij. Sabi e pyet nëse kishin kushtuar shumë".

*Moisi:* Bënë goxha.

*Sabi:* 1000 euro?

*Moisi:* Sa?

*Sabi:* 2000 euro…

Moisiu tregon se të dy bënin 18 mijë euro, por i kishte marrë për gjysmën e lekëve.

*Sabi:* I pagove 9 mijë euro me lekë në dorë?

*Moisi:* Po.

*Sabi:* Nuk kishte ndonjë telekamera?

*Moisi:* Jo. Vetëm ajo përpara gjykatës.

Moisiu i tregon se njërin nga byzylykët ia ka marrë nënës dhe tjetrin gruas së tij me gurë të çmuar dhe diamante.



Seancë parlamentare

### Ambasadori i SHBA: Shumë politikanë shqiptarë i kanë shpëtuar drejtësisë në këto 27 vite

# Lu: 'Tahiri', drejtësi. Askush s'është mbi ligjin

## *"Në komunizëm burgoseshin të pafajshëm. 27 vjet krime nga të majtë e të djathtë"*

Valentina Madani

Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, theu dje heshtjen, duke u përfshirë në debatin e fortë të çështjes "Tahiri". Pa tone kritike, por me mesazhe të qarta dhe të drejtpërdrejta, diplomati amerikan u përfshi dje në ato që ai i quajti "polemika rreth ish- ministrit të Brendshëm", duke bërë kontrastin para dhe pas diktaturës në Shqipëri dhe gjyqeve në kohën e Enverit. Ambasadori Lu rikthehet pas në kohë, duke kujtuar periudhën e komunizmit, ku sipas tij, njerëz të pafajshëm dërgoheshin në burgjet më të tmerrshme. Për këtë, diplomati amerikan kërkon që më parë të zbardhet e vërteta, referuar kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm si i përfshirë në trafik ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Duke kërkuar përfshirjen qytetare në shërbim të së vërtetës, ambasadori amerikan i qëndroi deklaratës njësoj si Hojt Brajan Ji: "Askush nuk duhet të jetë mbi ligjin". Në një takim me Këshillin



Ambasadori amerikan, Donald Lu

**MAJA KOÇIJANÇIÇ**

Zëdhënësja e Komisionit Europian, Maja Koçijançiç u shpreh dje për çështjen "Tahiri". "Ju e dini që Komisioni Europian përgatit raportin e tij vjetor, ku kjo do të jetë në një vëzhgim të rreptë, duke qenë se lufta kundër krimit të organizuar dhe reforma e drejtësisë janë prioritete", u shpreh ajo në një konferencë për shtyp, e pyetur nga gazetarja Erisa Zykaj.

Rinor të Ambasadës, Donald Lu përmendi se Shqipëria është përballur prej 27 vitesh me problemin e turpshëm të politikanëve të fuqishëm, nga të dyja kahet politike, që kanë kryer krime të tmerrshme dhe i kanë shpëtuar drejtësisë. "Brezat e kaluar kanë dështuar, por ju do të keni sukses. Ju do të mposhtni korrupsionin. Por së pari, më lejoni të them dy fjalë në lidhje me polemikat aktuale rreth ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Të gjithë ju jeni duke parë të shkruhet historia në këtë vend. Ajo që dini është se në komunizëm, Shqipëria kishte problemin e turpshëm të udhëheqësve komunistë, që dërgonin njerëz të pafajshëm në burgjet më të tmerrshme në Spaç, në Burrel dhe në Qafë Bar. Në 27 vitet e fundit, ky vend është përballur me problemin e turpshëm të politikanëve të fuqishëm nga e djathta dhe nga e majta, që kanë kryer krime të tmerrshme dhe i kanë shpëtuar drejtësisë, pa pushim", deklaroi z.Lu. Ai shtoi: "Nuk do të ishte e përshtatshme për mua të them nëse Saimir Tahiri është fajtor apo i pafajshëm. Por, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ju si drejtues të shoqërisë civile, ju si të rinj dhe ju si qytetarë të Shqipërisë të zbuloni të vërtetën. E drejta për të ditur të vërtetën nuk i përket asnjë partie politike. U përket qytetarëve të Shqipërisë. Ju nuk jeni gjyqtarë apo prokurorë, por jeni njerëz që votoni. Ju i dhatë besimin tuaj këtij personi si anëtar i Kuvendit dhe si minister i lartë i kabinetit. Është përgjegjësia juaj të kërkoni që publiku të dijë të vërtetën për këtë çështje. Nëse është i pafajshëm, njerëzit duhet ta dinë këtë. Nëse është fajtor, ai duhet të përballet me drejtësinë", theksoi ambasadori Donald Lu.

### Hidhet shorti i përzgjedhjes së dosjeve

## Fillon vetingu, të parët në "sitë" gjykatësit e Kushtetueses

Vetingu fillon zyrtarisht dhe nis me trupën e Gjykatës Kushtetuese. Burimet i thanë "Top Channel" se në Gjykatën Kushtetuese është hedhur shorti për të përzgjedhur 5 dosje gjykimi të çdo gjyqtari atje. Vetingu nis me kryetarin e kësaj gjykate, Bashkim Dedja, i rizgjedhur pak javë më parë për një mandat të dytë dhe pas tij, në sitë kalojnë edhe anëtarët Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo. Procesi i vetingut përfshin kontrollin e pasurisë së gjyqtarëve të lartë, të afërmve të tyre, por edhe lidhjet që ata kanë pasur gjatë ushtrimit të detyrës me persona që kanë lidhje me krimin. Sipas të njëjtave burime, në total janë përzgjedhur 35 dosje të 7 gjyqtarëve kushtetues, të cilat pas vlerësimit nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, do t'i përcillen me një relacion Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Këto dosje i përkasin gjykimeve të vitit 2013-2016, ndërsa relacioni i inspektoratit të KLD-së do t'i bashkëngjitet relacionit të Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe Drejtorisë së Informacionit të Klasifikuar. Nuk jepen detaje se sa do të zgjasë ky proces i rivlerësimit të gjyqtarëve kushtetues, ndërsa ditë më parë ky institucion festoi edhe 25-vjetorin. Të parët në veting do të jenë Bashkim Dedja, kryetar; Vitore Tusha, anëtare; Altina Xhoxhaj, anëtare; Fatmir Hoxha, anëtar; Gani Dizdari, anëtar; Besnik Imeraj, anëtar; Fatos Lulo, anëtar.




REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Kreu i PD: Tahiri nuk do shpëtojë. Jo bojkot, narko-shteti drejt çmontimit

# Rama: Don, faleminderit! Basha: Lu është me ne

## *Kryeministri: S'i kam intimiduar prokurorët*

Valentina Madani

Kryeministri Edi Rama dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha e shohin në këndvështrime të ndryshme deklaratën e ambasadorit amerikan Donal Lu lidhur me çështjen "Tahiri". Z.Rama shkruan në "Facebook": "Faleminderit Don! Një mesazh i qartë për shqiptarët që duan drejtësi, jo gjyqe komuniste për këdo që kanë votuar a paguar me taksat tyre".

Ndërsa në një intervistë për TV "Klan", Rama tha dje se "kush mendon se Shqipëria është atdheu i krimit të organizuar dhe fatkeqësisht një pjesë e rëndësishme e konsiderueshme e medias sonë e promovon këtë imazh, thjesht gabon. Rezultati që ka pasur kjo qeveri në luftë me krimin e organizuar nuk e ka pasur asnjë qeveri më parë". Ai mohoi të ketë intimiduar prokurorët. "Unë thjesht kam mbajtur qëndrimin e Partisë Socialiste, bazuar në raportin e Komisionit tonë të Mandateve dhe në çfarë kam parë me sy dhe kam dëgjuar me veshë si të gjithë shqiptarët", tha Rama. "Desha t'ju kujtoj atyre që të bëjnë punën e tyre të shkëputur telefonikisht apo në çfarëdo forme tjetër nga partitë politike dhe të çojnë përpara një proces për të cilin kanë mbaruar shkollën, kanë edhe eksperiencën e nevojshme që mos turpërojnë institucionin dhe të mos na turpërojnë të gjithëve", ishte mesazhi i Ramës për prokurorët.

**TAKIMI**

Çështja "Tahiri" ishte në qendër të një takimi që kreu i PD-së, Lulzim Basha zhvilloi në mesditë me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara, Donald Lu. Z.Basha deklaroi se nuk do të ketë bojkot dhe se beteja parlamentare do të vijojë për të vendosur para drejtësisë Saimir Tahirin. Lideri i PD-së u shpreh se ish-ministri i Brendshëm nuk do të shpëtojë. Kreu i demokratëve paralajmëroi dal-jen e ish-ministrit të Brendshëm përpara bankës të të akuzuarve si i implikuar në trafikun e lëndëve narkotike. I pyetur për deklaratën e ambasadorit Lu dhe interpretimin që i bëri kryeministri, Basha u shpreh ndër të tjera se SHBA foli qartë për çështjen "Tahiri", ndërsa Rama kapet pas fijes së kashtës. Ai tha se Tahiri është vetëm një nga hallkat e narkoshtetit. "Saimir Tahiri nuk do i shpëtojë drejtësisë, faktet e dala publikisht dhe që disponohen nga prokuroria do të bëjnë që partnerët do të bëjnë të mundur që të marrë përgjegjësitë penale për mbrojtjen e bandës kriminale. Tahiri është vetëm fillimi, kjo luftë sapo ka filluar. Tahiri është një alarm i kuq i ndezur në kancelari. Qeveria e SHBA foli qartë, unë nuk interpretoj qëndrimet e tyre, i kanë dhënë mbështetje prokurorisë dhe gjykatës që dënimit të mbrojtjes përmes imunitetit", deklaroi kreu i PD-së. Sipas Bashës, "qëndrimi i Ramës është i dëshpëruar dhe kërkon të kapet pas fijes së kashtës. Rama refuzon të bëhet pjesë e zgjidhjes dhe është pjesë e problemeve. Saimir Tahiri është vetëm njëra hallkë e narko-shtetit, ndërsa hallkat e tjera janë Arben Ndoka, Armando Prenga, Elvis Roshi dhe Vangjush Dako". Kreu i PD-së vuri në dukje se Tahiri nuk është i vetmi zyrtar i lartë i implikuar, teksa iu referua dokumenteve e fakteve, që sipas tij disponojnë partnerët ndërkombëtarë. "Jemi në kontakt. Partnerët dhe opozita kanë informacione mbi rolin e politikanëve me pushtet në kthimin e Shqipërisë në bazë droge - tha Basha.



Ambasadori Donald Lu dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha

**"NDJESA" E RAMËS**

Kryeministri i vendit, Edi Rama, një ditë pasi fyeu gazetarët me një tufë epitetesh deri në 'idiotë', në një intervistë për TV "Klan" u shpreh se fjala idiot nuk u atribuohej gazetarëve, por pyetjeve. "Ky është këndvështrimi im, mund ta kem gabim, por është opinioni im. Dhe nëse pushteti i katërt ka të gjithë lirinë bashkë me detyrimin që atë liri ta vërë në dispozicion të informimit të njerëzve, ata që nuk janë pjesë e atij pushteti po janë pjesë e pushteteve të tjera, kanë absolutisht të drejtë që të kenë opinionin e tyre për pushtetin e katërt", u shpreh Rama. Kryeministri u shpreh se, edhe pse mban këtë pozicion, nuk mund të qëndrojë kokulur karshi spekulimeve që ka në media.



**Reagimi**

**PETRIT VASILI**

"Amerikanët Lu dhe Hoyt Yee folën drejt, askush s'mund të jetë mbi ligjin. Kryeministri në hall doli mbi ligjin dhe bëri gjyq politik, që të mos gjykohen të tijtë dhe ai vetë. Lu dhe Yee thanë të dalë e vërteta. Kryeministri i trembur i ngre barrikadë dhe voton kundër të vërtetës, që ajo të mbytet e të mos dalë", shprehet Vasili.

### "Çfarë i lidh Habilajt me Tahirin"

## Berisha: Dëshmi tragjike e instalimit të narko-shtetit

Ish-kryeministri Berisha reagoi dje pas falënderimit publik, që kryeministri Edi Rama i bëri ambasadorit të SHBA-ve Donald Lu sa i takon çështjes "Tahiri". Berisha në mesazhin e tij e quajti reagimin e Ramës si dëshmi tjetër tragjike e instalimit të nakro-shtetit në Shqipëri. "Falënderimi Noriegës për ambasadorin Lu, dëshmi tjetër tragjike e instalimit të narko-shtetit në Shqipëri!", shkruan Berisha. Po dje ai publikoi emrin e një tjetri oficeri policie, që flet për lidhjet e Habilajve. Bëhet fjalë për Antonio Nazerajn, një oficer Antidroge në policinë e Fierit, i larguar nga detyra. Sipas dëshmisë së tij, të cituar nga Berisha, Habilajt me makinën e ish-ministrit Saimir Tahiri me targë AA 003 refuzonin kontrollet e policisë dhe në një rast të shoqërimit, u urdhërua lirimi i tyre dhe bëri që ai të vihej në shënjestër për eliminimin fizik dhe nisjen e procedurave për largimin e Nazerajt. "Një oficer tjetër i Antidrogës kryqëzon Tahirin, vërteton lidhjet e tij kriminale me Habilajt! Përveç Zaganit, një oficer tjetër i Antidrogës së Fierit, Antonio Nazeraj dëshmon në media: Habilajt me makinën e Tahirit me targë AA003 refuzonin kontrollet e policisë, pas shoqërimit të tyre, në një rast në polici, jo vetëm u urdhërua lirimi i menjëhershëm i tyre dhe makinës, por bëri që ai të vihej në shënjestër të bandës për eliminimin e tij fizik dhe nisjen e procedurave që sollën largimin e tij nga policia!", tha ai.



### "Më keq se në '97, qeverisin oligarkët"

## Kryemadhi: Qytetarët të ngrihen, të mos ia lëmë vendin "djallit"

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, shprehu dje shqetësimin për situatën e rëndë të krimit në vend. Gjatë një takimi me krerët e degëve të LSI në rrethe, ajo u bëri thirrje qytetarëve që të ngrihen dhe të marrin në dorë fatet e vendit. Sipas saj, vendi është në pushtetin e oligarkëve, ndërsa kërkoi mobilizimin e qytetarëve, në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet. Duke shpallur hapjen e LSI-së, Kryemadhi tha se angazhimi i intelektualëve dhe akademikëve duhet të bëhet për të mos e lënë vendin, siç tha ajo, në "duar të djallit". "Qeveria kujdeset vetëm për një grup oligarkësh, të cilët janë pranë saj, qeverisë. Kësaj qeverie nuk ia ndjen që me mijëra fëmijë shqiptarë i zë gjumi të uritur, sepse qeveria varfërinë e quan sëmundje dhe drogën ilaçin e saj. Qytetarët meritojnë të ndjehen shqiptarë në vendin e tyre dhe jo të huaj. Të ngrihen në këmbë për të drejtat e tyre dhe të marrin në dorë frenat e vendit. Duhet t'i mobilizojmë shqiptarët, që zëri i tyre të dëgjohet, të fuqizojmë energjinë e tyre. LRI do ketë rolin kryesor për të zgjuar shpresën e qytetarëve", tha zj.Kryemadhi. Ajo njoftoi hapjen e LSI-së për këdo që beson në kauzën tonë, kushdo që ndjehet i braktisur, i varfëruar, për t'ia dalë në këtë betejë që nuk është e lehtë me krimin dhe bandat. "LSI do jetë krahëhapur për mendimin intelektual, botën akademike, ekspertët, trurin e vendit, të cilët duhet të angazhohen në politikën e vendit, sepse ndryshe historia do t'i akuzojë për apatizëm. I referohem një shprehjeje të urtë popullore, 'djalli mbizotëron kur njerëzit e mirë heshtin dhe nuk bëjnë asgjë'. Duhet të marrim një vendim përfundimtar për të vepruar, ose t'ia lëmë vendin në dorë këtij 'djalli'", theksoi Kryemadhi.



# SITUATA POLITIKE
## PRESIDENTI

Presidenti merr pjesë në konferencën për vendimet e drejtësisë

# Ilir Meta: Zbatimi i vendimeve të gjyqësorit, ende larg standardeve

## *Shmang komentet për Tahirin: Institucionet, bashkë kundër drogës*



Darina Tanushi


Presidenti i Republikës, Ilir Meta

Presidenti i Republikës, Ilir Meta refuzoi të komentojë dje, çështjen "Tahiri", i pyetur nga gazetarët, pas pjesëmarrjes në Konferencën ndërkombëtare "Ekzekutimi i vendimeve të gjyqësorit - garanci për një ekonomi efikase", Meta bëri thirrje që institucionet të bashkohen në luftën kundër drogës e trafiqeve. "Nuk kam asnjë koment për çështjen e imunitetit, por të gjithë forcat politike dhe institucionet e drejtësisë duhet të bashkohen në luftën kundër trafiqeve dhe kundër drogës në përpjekjen për sundimin e ligjit", -tha Meta. Ndërkohë në fjalën që mbajti në konferencë, Meta i kërkoi parlamentit që në kuadër të reformës në drejtësi të reformojë edhe shërbimin përmbarimor, i cili sipas tij shfaq problematika në funksionim. "Një sistem drejtësie që funksionon normalisht në të gjitha hallkat e tij, pa diskutim që sjell si rezultat, një drejtësi funksionale, që konsolidon në vijimësi sigurinë juridike të shtetasve dhe normalisht edhe të biznesit dhe të sipërmarrësve në një vend. Një drejtësi funksionale është ajo ku vendimi i gjykatës ekzekutohet dhe nuk diskutohet!",- tha Presidenti. Sipas tij, " Është detyrë primare e organizmave shtetërore që të ndërmarrin të gjitha veprimet për t'u ofruar qytetarëve siguri juridike, e cila garantohet duke krijuar një sistem ligjor të shëndoshë, dhe nga ana tjetër, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike, ku një prej të cilëve është edhe shërbimi përmbarimor".

Kreu i shtetit tha se, "Zhvillimi ekonomik i një vendi është i lidhur ngushtë me cilësinë e sistemit të drejtësisë së tij sepse, nëse ky sistem garanton mbrojtjen dhe ekzekutimin e të drejtave, atëherë kjo klimë pozitive do të nxitë iniciativa dhe sipërmarrës të rinj, për t'u bërë pjesë e kësaj klime". "Asnjë investitor i huaj nuk do të dëshironte të zhvillonte aktivitetin e tij, për më tepër, të investonte në një vend të pasigurt, ku drejtësia shtrembërohet, apo ku vendimi i gjykatës injorohet dhe nuk ekzekutohet. Çdo sipërmarrës që shfaq interes për Shqipërinë, interesohet më së pari për sistemin fiskal dhe për mënyrën se si drejtësia funksion, pasi ai dëshiron ta ketë të qartë se cila është politika mbështetëse shtetërore, dhe cila është cilësia e shërbimit në sistemin gjyqësor",- nënvizoi Presidenti.

Meta tha se, "Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në Shqipëri, është ende larg standardeve europiane, qoftë për sa i përket numrit të vendimeve të ekzekutuara, kohëzgjatjes së procesit, si dhe cilësisë së shërbimit, që i ofrohet qytetarëve nga përmbaruesit gjyqësorë privat apo publik". "Duke shfrytëzuar mundësinë që më jepet, i përcjell një mesazh Kuvendit, që të tregojë kujdesin e duhur në diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e paketës ligjore, që rregullon profesionet e lira, ku pjesë shumë e rëndësishme është shërbimi përmbarimor. Ndërhyrjet në legjislacion duhet të jenë të mirëmenduara, të plota dhe në koherencë me standardet më të mira evropiane",-tha Meta. "Ajo që qytetarët presin është, që drejtësia jo vetëm të jepet nga gjykata, por edhe të ekzekutohet në tërësinë e saj, pasi një vendim gjyqësor i pa ekzekutuar është një tjetër padrejtësi. Ekzekutimi në kohën dhe me cilësinë e duhur i një vendimi gjyqësor është tregues kyç se drejtësia funksionon, dhe njëkohësisht ndihmon për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik", -u shpreh Presidenti.



### Presidenti pret nënkryetaren e Asamblesë Kombëtare të Serbisë

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje, në një takim të veçantë nënkryetaren e Asamblesë Kombëtare të Republikës së Serbisë, Gordana ?omi?, e cila është njëkohësisht aktiviste e "Rrjetit Politik të Grave" dhe po zhvillon një vizitë pune dyditore në Shqipëri, për të marrë pjesë në Forumin me temë: "Shqipëria dhe Serbia - drejt një të ardhmeje të përbashkët në Bashkimin Evropian". Duke iu referuar marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-Serbi, Presidenti Meta vlerësoi ecurinë e tyre pozitive dhe frymën e mirë të bashkëpunimit në rritje. Të dy bashkëbisedues it ndanë të njëjtin mendim lidhur me nevojën e forcimit të mëtejshëm të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit rajonal, duke e konsideruar atë si një element thelbësor, jo vetëm për konsolidimin e paqes dhe rritjes së sigurisë në rajon, por edhe në kuadër të axhendës evropiane dhe integrimit në Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, Presidenti Meta vlerësoi edhe mesazhet më të fundit inkurajuese që vijnë nga palët për mundësinë e rivitalizimit të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

### Ministrja konfirmon fondin, i përgjigjet deputeti i LSI-së

# Xhaçka: Radarë të rinj. Luan Rama: Pse nuk kanë qenë në punë 3 vjet?


Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka



Deputeti i LSI-së, Luan Rama

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka deklaroi se është siguruar fondi për blerjen e një sistemi të ri radar ajror, që është sipas saj, investimi i parë në demokraci për ruajtjen e qiejve shqiptarë. Xhaçka konfirmoi se janë 400 mln lekë shtesë për buxhetin e mbrojtjes me qëllim blerjen e sistemit radar ajror, ndërsa do të ketë grupe pune me ministrin Xhafaj për vëzhgimin e hapësirës detare. Ministrja paralajmëroi se do të nxjerrim konkluzionet e nevojshme dhe përgjegjësitë e rastit pas vëzhgimit të hapësirës detare. "Së bashku me ministrin e Brendshëm, kolegun Fatmir Xhafaj kemi ngritur një grup të përbashkët inspektimi për të inspektuar në detaje situatën aktuale me vëzhgimin e hapësirës detare. Do të nxjerrim konkluzionet e nevojshme dhe përgjegjësitë e rastit",- tha ministrja. Por menjëherë ka reaguar deputeti i LSI-së, Luan Rama. "Zonja ministre e Mbrojtjes paska thënë se Ministria e Mbrojtjes do të blejë radarë të rinj! Po përse nuk kanë qenë në punë prej më shumë se tre vitesh radarët ekzistues, kur do të na e thotë?! Po përse sistemi i radarëve është venë në shërbim të grupeve kriminale të trafikantëve të drogës, kur do të na e thotë?! Po përse janë cenuar standardet e sigurisë kombëtare në kontrollin e hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë kur do të na e thotë?!",- u shpreh dje, Rama. Vetë Xhaçka reagoi duke shkruar në "FB": "I nderuari deputet Luan Rama, në mënyrë të përsëritur sulmon Ministrinë e Mbrojtjes me "të vërteta" të pavërteta". Ajo i sugjeroi deputetit "Të kërkojë një interpelancë parlamentare" dhe tha se do të jetë në dispozicion për të dhënë të gjithë informacionin zyrtar, me përgjegjësi të plotë institucionale.

**SHIFRAT**

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka konfirmoi se janë 400 mln lekë shtesë për buxhetin e mbrojtjes, me qëllim blerjen e sistemit radar ajror, ndërsa do të ketë grupe pune me ministrin Xhafaj për vëzhgimin e hapësirës detare. Ministrja paralajmëroi se do të nxirren konkluzionet e nevojshme dhe përgjegjësitë e rastit pas vëzhgimit të hapësirës detare.



### Delegacioni i deputetëve shqiptarë, seminar në senatin italian

## Bushati: Vetingu, i rëndësishëm për një imazh të ri të gjyqësorit

Seminari i Këshillit Parlamentar të Europës me temë "Promovimi i transparencës dhe përgjegjësisë për parlamentarët u mblodh dje në senatin italian. Në këtë seminar merrte pjesë edhe Shqipëria me një delegacion përfaqësues, që kryesohej nga Ervin Bushati. Bushati theksoi rëndësinë e procesit të vetingut. "Kjo është e nevojshme për të krijuar një imazh të ri të gjyqësorit, i cili më parë ka qenë i njollosur keqas. Suksesi i këtij ligji nisi që me votimin në Kuvend, ku u votua nga të gjithë deputetët, por ky është vetëm fillimi. Ne kërkojmë mirëkuptimin e partnerëve tanë europianë, që të mbështesin hapat e shpejtë në një kohë tepër të limituar, që ne kemi pasur në dispozicion për të zhvilluar shoqëri të lira, të qeverisura nga sundimi i ligjit dhe harmonia demokratike", u shpreh Bushati.



Pjesë e delegacionit shqiptar ishte edhe nënkryetarja e Parlamentit, Vasilika Hysi, e cila përmendi ecurinë e legjislacionit shqiptar që prej vitit 2005, përsa i përket konfliktit të interesit e deklarimit të pasurisë nga deputetët dhe funksionarët e Kuvendit. Hysi diskutoi mbi dhuratat që marrin dhe japin gjatë ushtrimit të detyrës deputetët. Një tjetër çështje ishte edhe diskutimi mbi kodin e sjelljes së deputetëve, për të cilin po punohet bashkërish me opozitën, për të krijuar një imazh të ri të integritetit të deputetit shqiptar e sjelljes se tij në Parlament. Punimet e seminarit do të vijojnë edhe sot, ku diskutimet do të vijojnë mbi promovimin e integritetit në qeverisje për të luftuar korrupsionin si dhe imunitetin parlamentar. Gjithashtu, pjesë e delegacionit shqiptar ishin edhe deputetët Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Luan Rama, Oriola Pampuri, Eduard Shalsi, Ulsi Manja, Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Almira Xhembulla dhe Genci Gjonçaj, sekretar i përgjithshëm i Kuvendit.

### Presidenti e ministri i Jashtëm grek, me dy qëndrime të ndryshme ndaj raporteve me Tiranën

# Pavlopulos: Shqipëria dëmton perspektivën e vet europiane

## *Kotzias: Vullnet për t'i zgjidhur problemet me dialog*

Presidenti grek, Prokopis Pavlopulos akuzoi Shqipërinë se me këtë sjellje që shkel të drejtat themelore të njeriut po dëmton të ardhmen e saj evropiane. Por në tjetër drejtim e ka shtrirë deklaratën e tij ministri i Jashtëm, Nikos Kotzias, i cili tha se shpreson se palët mund t'i zgjidhin çështjet me dialog. Nga Selaniku, Pavlopulos deklaroi edhe një herë se sidomos udhëheqja aktuale e Shqipërisë tregon shenja të një sjelljeje, që nuk i shkon për shtat një vendi pjesëtar të komunitetit ndërkombëtar dhe kandidat për anëtarësim në BE. "Me sjellje që shkelin në mënyrë flagrante të drejtat themelore të njeriut, siç janë sjelljet ndaj minoritetit tonë, si dhe sjelljet që cenojnë të drejtën e shenjtë të pronës, këtu nuk mund të thuhet se ai vend ka një perspektivë europoiane", ka thënë Presidenti i Republikës greke. "Shqipëria dëmton perspektivën e saj europiane dhe ne nuk mund të rrimë duarkryq kundrejt sjelljeve të tilla", shtoi kryetari i shtetit grek. Ndërsa nga ana e tij, Kotzias ka sqaruar takimin me ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati muajin e ardhshëm në Kretë, në përpjekje për të finalizuar zgjidhjen e sa më shumë problemeve dypalëshe. Lajmi është dhënë gjatë një konference për shtyp të ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias, në Athinë. "Kemi vullnetin që t'i zgjidhim problemet, pse nuk duam që t'i gjejmë përpara gjatë procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE", deklaroi Kotzias, duke shtuar se, "zgjidhja diku është e lehtë, diku e vështirë, prandaj dhe kemi rënë dakord që zgjidhja e tyre të jetë një paketë e vetme". Ndërkaq, shefi i diplomacisë greke nuk ka dhënë detaje se cilat janë çështjet që do të vihen në rrugën e zgjidhjes. Por, ai ka thënë se për "problemet më të vështira" është krijuar një grup koordinues që po vazhdon diskutimet. Ministri i Jashtëm grek u pyet nga korrespondenti i "Ora News" nëse ishte koha e përshtatshme për takimin e Kretës, pas tensionimit të ri të raporteve shqiptaro-greke, shkaktuar nga deklarata Athinës, që ndërlidhte zhvillimet në çështjen "Tahiri" me zhvillimet në Himarë, si dhe përgjigjen e Tiranës, që akuzonte palën greke për ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë.


Presidenti grek, Prokopis Pavlopulos


Ministri i Jashtëm, Nikos Kotzias

**TAKIMI**

Ministri Ditmir Bushati dhe homologu i tij grek, Nikos Kotzias mund të takohen në Kretë në fillim të nëntorit. Takimi do mbahet në datat 10, 11 dhe 12 nëntor dhe me mundësi shtyrjeje deri në arritjen e marrëveshjes detare, për të cilën burimet pretendojnë se ka dakordësi për termat juridikë dhe mbetet vetëm negocimi teknik.

"Negociatat do të vazhdojnë", tha ministri i Jashtëm grek dhe shtoi: "Po të mos i zgjidhim problemet, do të ketë vazhdimisht deklarata të ashpra". Kotzias përshëndeti pezullimin e prishjes së banesave në Himarë, por përsëriti pakënaqësinë e Athinës mbi ligjin për pakicat kombëtare. "Ai është një ligj shumë i mirë, por edhe një hap mbrapa", tha Kotzias, duke shpjeguar se ligji merr për bazë regjistrat e gjendjes civile, ku shumë prej minoritarëve gjatë regjimit komunist nuk u regjistruan sipas përkatësisë etnike. Gjithsesi, ministri i Jashtëm grek vazhdon t'i shqyrtojë me një optikë optimiste marrëdhëniet me vendin fqinj, duke theksuar se minoriteti grek në Shqipëri dhe emigrantët shqiptarë në Greqi janë ura të forta miqësie. "Unë besoj shumë se mes palëve duhet të ketë dialog, ndaj edhe me palën shqiptare do të dialogojmë në mënyrë që çështjet të mos na dalin sërish para. Dëshira është që problemet t'i zgjidhim si një paketë. Shkojmë në takim për të gjetur zgjidhje për sa më shumë çështje të mundemi. Kemi një ekip koordinatorësh tepër efikasë, të cilët janë ndarë në katër ekipe dhe punojnë për zgjidhjen e problemeve. Natyrisht, ne duam t'i zgjidhim të gjitha kontestet me Shqipërinë", ka thënë Kotzias.

### Ambasadorja e Greqisë viziton Vlorën

## Eleni Sourani: Të shqetësuar për Himarën, të interesuar për minoritetin

Ambasadorja greke në Tiranë, Eleni Sourani, ka preferuar të mos japë deklarata politike rreth situatës së krijuar në vend. Në takimin me prefekten e Vlorës, Etjona Hoxha, ambasadorja ka kërkuar garanci për trajtimin e çështjes së Himarës me më shumë dashamirësi, ndërsa ka theksuar se prioritet mbetet trajtimi i banorëve të kësaj zone. "Nuk kam asgjë për të deklaruar rreth çështjes së Himarës më shumë sesa është folur. Jam këtu për një takim të mirëfilltë për bashkëpunim me Vlorën dhe zonat e saj periferike. Jemi të


Ambasadorja greke, Eleni Sourani

interesuar për të pasur një marrëdhënie të qëndrueshme mes dy shteteve", ka deklaruar Sourani. Sa i takon Himarës, ajo ka theksuar se, "banorët e saj duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe projektet vendore nuk duhet t'i cenojnë ata". "Shteti grek është i vëmendshëm për të gjitha zonat minoritare. Sa i përket Himarës, me aq pak shqip sa di, mund të them se rëndësi ka që projekti të realizohet pa ndikuar shumë në komunitetin himarjot", ka shtuar diplomatja. E pyetur rreth deklaratave të Ministrisë së Jashtme greke, ambasadorja është përgjigjur se vjen për herë të parë Vlorë dhe nuk do të preferonte të bënte komente politike. Ndërkohë, prefektja Hoxha ka garantuar se projekti do të ecë përpara me zbatimin e tij, ashtu si edhe një numër i konsiderueshëm projektesh, të cilat kanë gjetur zbatim në qarkun e Vlorës.

Operacioni "Taksi e lirë 2", pas denoncimit të prindërve të një 18-vjeçareje

# Shkatërrohet rrjeti i prostitucionit, përfundojnë në pranga 10 persona

## *Shfrytëzonin vajzat në hotele për 50 deri 150 euro*

Ina Allkanjari





Foto nga vendi i ngjarjes

Policia e Tiranës në një aksion të koduar "Taksi e lirë 2" ka goditur një grup kriminal të shfrytëzimit të prostitucionit, duke arrestuar 10 persona dhe proceduar 3 të tjerë. Drejtori i policisë së Tiranës Ardi Veliu, në një deklaratë për mediat ditën e djeshme tha se policia e Tiranës në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, pas një hetimi 5 mujor, kanë bërë të mundur finalizimin e operacionit për shkatërrimin e këtij grupi të strukturuar kriminal. Mësohet se veprimtaria kriminale ku shfrytëzoheshin për prostitucion vajza të moshave të ndryshme ushtrohej në disa hotele në qytetin e Tiranës, një prej tyre në kryqëzimin e "Tregut elektrik". Për çdo vajzë që i ofronte seks klientëve, grupi merrte pagesat që varionin nga 50 deri në 150 euro. Ndërkohë mësohet se ishte pikërisht denoncimi i prindërve të një 18-vjeçareje, për largimin e saj nga banesa në muajin prill të këtij viti, që çoi në zbulimin e rrjetit të shfrytëzimit të prostitucionit në Tiranë. Gjithashtu, gjatë arrestimeve të bëra, në disa prej ambienteve është gjetur lëndë narkotike e llojit kokainë e ndarë në porcione, të cilat janë sekuestruar.

**OPERACIONI**

Shtetasit e arrestuar në flagrancë dhe ata të proceduar në kuadër të operacionit akuzohen për veprat penale të "Shfrytëzim prostitucioni" dhe "Mbajtje të vënie ne përdorim të ambienteve për prostitucion", "Prodhim dhe shitje të narkotikëve" si dhe "Prostitucionit". Janë vënë në pranga shtetasit: Ruzhdi Gapi, 41 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim i prostitucionit"; Edmond Shkalla, 49 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar më parë, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim i prostitucionit"; Albina Kasa, 26 vjeç, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar më parë, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim i prostitucionit"; A. Ndoja, 37 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar më parë, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Mbajtje të lokaleve për prostitucion"; Jani Murati (Gëzim Kasëmi), 59 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim prostitucioni"; Altin Sulejmanasi, 44 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim prostitucioni"; Elton Mimini, 23 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i pa dënuar, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Shfrytëzim prostitucioni"; A.L., 44 vjeçe, lindur dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar më parë, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Prostitucion"; F.P., 32 vjeçe, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar, akuzohet për kryerjen e veprës penale "Prostitucion" dhe "Prodhim e shitje të lëndëve narkotike"; D.D, 42 vjeç lindur dhe banues në Tiranë, i dënuar më parë. Ndërkohë janë proceduar në gjendje të lirë shtetasit me inicialet: D.D., 25 vjeçe, lindur në Tropojë dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar më parë; L.K., 25 vjeçe, lindur dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar më parë dhe shtetasja B.C., 39 vjeçe, lindur dhe banuese në Tiranë, e pa dënuar më parë. Mësohet se në këtë aktivitet kriminal shtetasit Ruzhdi Gapi dhe Gëzim Kasëmi, ishin në rolin e taksistit. Ata bënin të mundur transportimin e vajzave, që ushtronin prostitucion, në hotele të ndryshme të tilla si ambienti "Hotel" pranë kryqëzimit të "Tregut elektrik", në pronësi të shtetasit A.Ndoja. Ndërkohë organizatorët në këtë aktivitet të jashtëligjshëm, Albina Kasaj, Jani Murati, Gëzim Kasëmi, Ruzhdi Gapi, Edmond Shkalla, Altin Sulejmanasi dhe Elton Mimini, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë shfrytëzuar F.P. 32 vjeçe, A.L. 44 vjeçe, D.D. 25 vjeçe, B.C. 39 vjeçe, për të ushtruar prostitucion me klientët e gjetur prej tyre. Policia bën me dije se gjatë arrestimeve të bëra, në disa prej ambienteve është gjetur lëndë narkotike e llojit kokainë e ndarë në porcione, të cilat janë sekuestruar. Në këtë operacion janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 2 automjete, 9 aparate telefonike, 1 dozë kokainë si dhe një shumë prej 10.000 lekësh. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për hetime të mëtejshme, për të zbuluar lidhjet dhe shtrirjen e mundshme të këtij rrjeti kriminal.

**SHTETASIT E ARRESTUAR**

1. Ruzhdi Gapi, 41 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar.
2. Edmond Shkalla, 49 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar më parë.
3. Albina Kasa, 26 vjeç, lindur në Elbasan dhe banuese në Tiranë, e padënuar më parë.
4. A. Ndoja, 37 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar më parë.
5. Jani Murati (Gëzim Kasëmi), 59 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar.
6. Altin Sulejmanasi, 44 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar.
7. Elton Mimini, 23 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë, i padënuar
8. A.L., 44 vjeçe, lindur dhe banuese në Tiranë, e padënuar më parë.
9. F.P., 32 vjeçe, lindur në Fier dhe banuese në Tiranë, e padënuar.
10. D.D, 42 vjeç lindur dhe banues në Tiranë, i dënuar më parë.

**TRANSPORTIMI I VAJZAVE**

Në këtë aktivitet kriminal shtetasit Ruzhdi Gapi dhe Gëzim Kasëmi ishin në rolin e taksistit. Ata bënin të mundur transportimin e vajzave që ushtronin prostitucion në hotele të ndryshme, të tilla si ambienti "Hotel" pranë kryqëzimit të "Tregut elektrik", në pronësi të shtetasit A.Ndoja.



## Riatdhesohen 31 shtetas shqiptarë, shkelën rregullat e qëndrimit

31 shtetas shqiptarë janë riatdhesuar mbrëmjen e djeshme në aeroportin "Nënë Tereza" nga Franca dhe Belgjika, pasi kanë shkelur rregullat e qëndrimit në zonën Shengen. FRONTEX në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, atë franceze dhe belge kanë organizuar fluturimin me avion për të riatdhesuar këta persona. Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit u bëjnë thirrje të gjithë shtetasve shqiptarë të plotësojnë kriteret e lëvizjes së lirë në vendet e Bashkimit Europian. Shqipëria është një vend i origjinës së sigurt dhe çdo tentativë për të shkelur rregullat e lëvizjes së lirë nga ana e shtetasve shqiptarë do të ketë pasoja për ta. Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit u kërkojnë të gjithë qytetarëve të mos aplikojnë për azil, pasi asnjë kërkesë qoftë politike apo ekonomike nuk pranohet. Shanset për të fituar azil janë zero.

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :**

**"Apartament"** me sip. 237.15 m², Nr. Pas. 4/208+1-31, Vol.30, Fq.147, ZK 8514, e ndodhur ne Durres. Kjo pasuri eshte e hipotekuar në favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **71.719 Euro**. Ankandi do te zhvillohet **datë 16.11.2017 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.

**Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al**

**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :**

**1-** "Truall" me sip. 200 m² nga kjo ndretese 114 m2,Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur ne Sheq i Madh, Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi I është **54.400 Euro.** Ankandi per do te zhvillohet **datë 30.10.2017 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .

**2-** "Are" me sip. 9.159 m²,Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur ne Sheq , Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me të cilin fillon ankandi I është **58.400 Euro.** Ankandi per do te zhvillohet **datë 30.10.2017 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .

**Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.**

Zyra Permbarimore Kozeta Caka njofton shpalljen e ankandit te I per shitjen e "Pasurise se Paluajtshme te llojit are, me Nr. 101, te ndodhur ne ZK. 2947, vol 3, fq. 94, me siperfaqe 400 m2, Petrele, Tirane", ne pronesi te debitorit Ismail Gjata. Ankandi fillon me me cmim fillestar 1.713.256 leke.
Ankandi do te zhvillohet ne date 07.11.2017, diten e marte, ora 15:30 – 16:30, prane Zyres Permbarimore Private Kozeta Caka ne adresen: Bulevardi "Bajram Curri" , Pallati "Palma e Arte", Kati 1, Nr. 22, Tirane. Te interesuarit te kontaktojne ne Tel: +355 44532280.

### Zbardhet skema e krimit, 73-vjeçari qëlloi të parën gruan, pastaj kushëririn

# Vrasja e dyfishtë për pronën, nëna e muzikantit i dhuroi 2 m tokë autorit

## Banorët: Konflikti nisi pas kthimit të Alekos nga Greqia

Brikena Metaj

Një ditë pas vrasjes së bashkëshortëve Aleko dhe Afërdita Kosta, zbardhen detaje të reja në lidhje me ngjarjen e rëndë, e cila tronditi jo vetëm banorët e qytetit të Gjirokastrës, por të gjithë opinionin publik. Mësohet se gjithçka ndodhi për 2 metra tokë (truall), të cilën nëna e muzikantit 66-vjeçar ia kishte dhuruar para se të vdiste, nipit të burrit të saj, Apostolit për të zgjeruar ambientin para shtëpisë së tij, pasi e kishte të vogël. Apostoli ka ndërtuar murin rrethues, por pas kthimit nga emigracioni, Aleko i ka kërkuar djalit të xhaxhait të tij që ta prishte murin rrethues mes dy banesave të tyre, pasi i kishte hyrë në pjesën që ai e kishte me tapi. Por, kushëriri i viktimës ka refuzuar, duke i kujtuar se atë pjesë toke ia kishte dhuruar me gojë nëna e tij (Alekos). Ndërkaq, Aleko i ka kërkuar 73-vjeçarit që të zbatonte vendimin e Gjykatës së Gjirokastrës, e cila i kishte dhënë të drejtën e pronësisë, pasi ngjitur me murin kishte ngritur një barakë që do e rikonstruktonte dhe do e kthente në kuzhinë. Kaq është dashur që të nisë konflikti mes dy kushërinjve të parë, për të degjeneruar mëngjesin e së mërkurës në tragjedi. Plot 17 herë ka qëlluar autori i krimit mbi çiftin Kosta, duke i lënë të vdekur në vend. Dy viktimat u përcollën mesditën e djeshme në banesën e fundit. Ndërkaq, policia e Gjirokastrës ka rindërtuar skemën e vrasjes, e cila pohohet të ketë ndodhur në pak minuta.

**17 PLUMBA**

Sherret e vazhdueshme për pronën kanë çuar deri në çmenduri 73-vjeçarin Apostol Kosta, i cili mëngjesin e së dielës qëlloi me 17 plumba kushërirín e tij 66-vjeçar, Aleko Kosta dhe gruan e këtij të fundit, Afërdita Kosta. Mësohet se gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale granatën e dorës, e pashpërthyer, (për shkak të mungesës së ndezësit), si dhe 17 gëzhoja arme.



Bashkëshortët e vrarë, Aleko dhe Afërdita Kosta

### SKEMA E VRASJES

Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Gjirokastrës bënë dje me dije se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 07:25 të së mërkurës në vendin e quajtur "Sokaku i të Marrëve", në lagjen 'Palorto'. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se Apostol Kosta kishte hyrë në oborrin e banesës së çiftit me një granatë dhe një armë në dorë. Pasi ka hedhur granatën, e cila për fat nuk ka shpërthyer, i moshuari është futur brenda, ku ka hapur zjarr ndaj gruas së kushëririt të tij, e cila në ato momente ndodhej në aneksin e kuzhinës në katin e parë. Më pas, ai është ngjitur për në katin e dytë të banesës ku është përballur me kushëririn e tij, ndaj të cilit ka shkrehur armën. Në banesën e krimit gjendej edhe djali 19-vjeçar nga martesa e parë e Afërdita Kostës, i cili është ngritur i alarmuar nga zhurmat dhe është fshehur. Vetëm pak minuta më vonë, ai ka dalë për të parë se çfarë kishte ndodhur, ndërsa është përballur me një skena makrabre, ku ka parë të lyer në gjak njerkun dhe nënën e tij. Ndërkohë, në kushtet e tronditjes së rëndë, autori i dyshuar ka shkuar në shtëpinë e tij dhe me armën e krimit ka qëlluar veten me plumb në nofull, duke u plagosur. 73-vjeçari Apostol Kosta ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore në Spitalin e Traumës në Tiranë. Po të njëjtat burime sqaruan se në banesën ku ndodhi krimi janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale granata e dorës, e pashpërthyer, (për shkak të mungesës së ndezësit), si dhe 17 gëzhoja arme. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për veprime të mëtejshme.

### BANORËT

Vrasja për motive pronësie të 49-vjeçares Afërdita Kosta dhe burrit të saj Aleko Kosta ka shokuar banorët e qytetit muze. I afërmi i viktimave, Et'hem Beja tregoi dje për "GSH" mbi konfliktet e vazhdueshme që kishin dy familjet vetëm për 2 metra tokë. Sipas tij, çifti Kosta i kishte kërkuar autorit të krimit, Apostol Kosta që të shembte murin që e kishte ndërtuar sipas tyre në tokën që i takonte Aleko Kostës. "Kishin probleme, por besonin se do i zgjidhnin. Situata nuk dukej shqetësuese dhe ne as që e mendonim se do të ndodhte ajo që ndodhi. Fillimisht çifti kishte debatuar me Apostolin, pasi ata i kishin kërkuar që ai të prishte murin rrethues. Apostoli tha se nuk do e prishte murin rrethues, ndërkohë Aleko i kërkoi të zbatohet vendimi i gjykatës. Për 2 metra tokë u vranë", tha i afërmi i viktimave. Gjithashtu, Beja u shpreh se, "kur ishte gjallë nëna e Alekos, i kishte dhuruar Apostolit 2 metra tokë që edhe ai të zgjeronte pak shtëpinë, pasi e kishte të vogël. Por pasi vdiq nëna, Aleko i ka kërkuar Apostolit që të shembë murin rrethues". Një fqinje e viktimave u shpreh se, "Apostoli vuan nga zemra dhe ishte shumë rëndë. Nuk besoj se e ka bërë ai këtë krim". E moshuara (nuk deshi të identifikohej) pohoi se Apostol Kosta vuante nga zemra dhe nuk ishte mirë fizikisht, për të kryer këtë akt kaq të rëndë që ka si motiv konfliktin e pronësisë. Ajo hedh dyshime që krimin mund ta ketë kryer dikush tjetër. Ndërkohë, një tjetër fqinje pohoi se mëngjesin e së mërkurës, Apostoli kishte shkruar në banesën e çiftit dhe kishte debatuar me ta. "Unë dëgjova që ata po bënin debat që në mëngjes. Apostoli u tha: 'Jo vendim gjyqësor të keni ju, por unë murin nuk e prish'. Kurse ata i thanë: 'S'ke punë me ne'. Më pas Apostoli shkoi në shtëpi, mori armën dhe u gjuajti", rrëfehu fqinja.

**I AFËRMI I VIKTIMAVE**

"Aleko Kosta dhe Apostol Kosta kishin probleme me njëri-tjetrin, por besonin se do i zgjidhnin. Situata nuk dukej shqetësuese dhe ne as që e mendonim se do të ndodhte ajo që ndodhi. Fillimisht çifti kishte debatuar me Apostolin, pasi ata i kishin kërkuar që ai të prishte murin rrethues. Apostoli tha se nuk do e prishte murin rrethues, ndërkohë Aleko i kërkoi të zbatohet vendimi i gjykatës. Për 2 metra tokë u vranë", tha i afërmi i viktimave, Et'hem Beja.

**DYSHIMI**

Një fqinje e viktimave u shpreh dje për "GSH" se, "Apostoli vuan nga zemra dhe ishte shumë rëndë. Nuk besoj se e ka bërë ai këtë krim". E moshuara (nuk deshi të identifikohej) pohoi se Apostol Kosta nuk ishte mirë fizikisht, për të kryer këtë akt kaq të rëndë që ka si motiv konfliktin e pronësisë. Ajo hedh dyshime që krimin mund ta ketë kryer dikush tjetër.

## Italianit i gjenden në makinë 74 mijë euro të padeklaruara, policia ia sekuestron

**KAKAVIJË** - Policia kufitare e Kakavijës ka ndaluar një shtetas italian, pasi iu gjetën të fshehura në automjet rreth 74 mijë euro. Bëhet fjalë për R.G., 56 vjeç banues në vendin fqinj, i cili është shoqëruar në policinë e Gjirokastrës. Ai do të procedohet në gjendje të lirë për veprën penale "Mosdeklarim në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë". "Në datë 25.10.2017 u referuan materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për shtetasin R.G., banues në Itali, pasi në Pikën Kufitare Kakavije, nga punonjësit e policisë, në vijën e dytë të kontrollit, në automjetin e tij iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale shuma prej 74.600 euro, të cilat nuk i kishte deklaruar. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për veprime të mëtejshme", thuhej në njoftimin për shtyp të policisë.



## Aksion në Dibër, arrestohen 5 persona, parandalohet edhe vrasja për borxhin

DIBËR - Mbrëmjen e së mërkurës, policia e Dibrës ka parandaluar përshkallëzimin e një konflikti, duke arrestuar një person e sekuestruar armën e zjarrit me fishek në gojë, gati për qitje. Gjithashtu, gjatë 24 orëve të fundit janë zbardhur 6 vjedhje, si dhe është goditur një rast i prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike. Në pranga kanë përfunduar 5 persona, si dhe është shpallur në kërkim një tjetër. Për këto ngjarje janë sekuestruar armë zjarri, automjete, motorçikleta, lëndë narkotike e bimë narkotike të kultivuara. Sipas bluve, pas marrjes së informacionit për një konflikt të ndodhur në orët e pasdites midis dy personave në fshatin Shumbat, njësia Sllovë, konflikt i cili po përshkallëzohej në orët e mbrëmjes, ku njëra palë kishte një kallashnikov me vete, është ndërhyrë menjëherë. Në pranga ka përfunduar shtetasi Jetmir Kade, banues në Shumbat. Mësohet se 35-vjeçari ishte konfliktuar me shtetasin A.D., për një shumë prej 9 mijë lekësh që ky i fundit ia kishte borxh. Kade kishte marrë armën dhe dyshohet se ka qëlluar në ajër para banesës së tij dhe më pas kishte shkuar rreth 300 m larg banesës së tij për t'u sqaruar me shtetasin A.D. Ndërhyrja në kohë e policisë ka bërë të mundur parandalimin e një krimi të mundshëm. Po si rezultat i punës profesionale, policia e Dibrës ka zbardhur dhe dokumentuar 6 raste të vjedhjes së pronës. Konkretisht, në vijim të operacionit të nisur tri ditë më parë ku u arrestua një prej autorëve, Edison Çuku, 23 vjeç, banues Dobrovë (i dënuar më parë për vjedhje), blutë ndaluan dhe 22-vjeçarin Gentjan Ismaili, banues në njësinë administrative Melan (i dënuar më parë për vjedhje). Për këta dy shtetas është dokumentuar me prova ligjore autorësia e 6 rasteve të vjedhjeve të ndodhura më parë. Gjithashtu, policia e Dibrës ka arrestuar F.Ç., 28 vjeç, banues në Tiranë, i shpallur në kërkim për vjedhje. Në pranga ka përfunduar edhe Imer Lamallari, 50 vjeç, banues në fshatin Vasie, njësia administrative Kala e Dodës-Dibër. Ndërsa, është shpallur në kërkim djali i tij 26-vjeçar, pasi gjatë kontrollit të ushtruar para banesës janë gjetur të kultivuara disa bimë kanabis. Kurse, në stallën e bagëtive u gjet një fuçi plastike me bimë të thara kanabisi, me peshë 3 kg e 30 gr.

## PENSIONISTET
### PERFITUESIT

Pensionistët, 4 certifikata dhe disa dokumente sigurohen 'online'

# Kreu i ISSH: Ndryshon procedura për dokumentet e pensionit

## Astrit Hado: Certifikatat për pension merren 'online'



Katër certifikata dhe një sërë dokumentesh të tjera do të sigurohen 'online' dhe një pensionist duhet vetëm të paraqitet në zyrat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Ky institucion bën me dije se për pensionistët nuk ka më arsye të humbasin kohë në sportelet e gjendjes civile si dhe të shpenzojnë para, pasi dokumentet janë 'online'. Kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, bën të ditur se një pensionist nuk ka më arsye përse të shkojë në gjendjen civile për të tërhequr certifikatat, që i duhen për të përfituar pension. Përmes procesit të rregullimit që parashikon transferimet 'online' të dokumenteve, punonjësit në zyrat e pensioneve i tërheqin vetëm ato përmes sistemit. "Katër lloj certifikatash mund të gjenden 'online' përmes portalit 'e-Albania', që është certifikata familjare, certifikata personale e cila në përgjithësi nuk kërkohet, certifikata e vdekjes në rastet kur pensionistët ndërrojnë jetë dhe certifikata e martesës për ato martesa që janë realizuar pas vitit 2008. Përpara vitit 2008 nuk janë



Kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado

> **ASTRIT HADO**
>
> "Ne sigurojmë vetë edhe një sërë dokumentesh të tjera, të cilat prodhohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nga segmente të caktuara të administratës së sigurimeve shoqërore si dhe dëshminë e penalitetit për përfitimet suplementare nuk ua kërkojmë më qytetarëve, por e marrim ne pranë Ministrisë së Drejtësisë"

dixhitalizuara, që do të thotë janë mbi bazë letre. Të gjitha ato certifikata do të sigurohen vetë në portalin tonë përmes lidhjes që kemi me gjendjen civile. Qytetari vetëm deklaron", thotë Hado në një intervistë për "Ora News". Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, tha se edhe një sërë dokumentesh të tjera tërhiqen 'online'. "Ne sigurojmë vetë edhe një sërë dokumentesh të tjera, të cilat prodhohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nga segmente të caktuara të administratës së sigurimeve shoqërore si dhe dëshminë e penalitetit për përfitimet suplementare nuk ua kërkojmë më qytetarëve, por e marrim ne pranë Ministrisë së Drejtësisë", bën të ditur Hado.

**PAGESAT**

"Në këtë mënyrë, pensionisti përfiton duke mos paguar para dhe duke mos shpenzuar kohë. Çdo certifikatë kushton 500 lekë të vjetra, minimalisht për çdo përfitim ne kërkojmë 2-3 certifikata, që për një pensionist është e qenësishme, por është edhe koha e harxhuar. Nuk do të shkojnë qytetarët pensionistë të mbajnë radhë në gjendje civile që të marrin certifikatë. Apo ndonjëherë për shkak të shumë arsyeve mund ta marrin edhe gabim, dhe do të duhet të rikthehen dhe ta marrin prapë. I gjithë sistemi i ISSH është dixhitalizuar, ndaj pensionistët aktualisht përfitojnë nga këto lehtësira", bën të ditur drejtori i ISSH-së, Astrit Hado.

### VËRTETIM PENSIONI

Shërbimi elektronik "Vërtetim pensioni" u mundëson qytetarëve të marrin 'online' vërtetimin e përfitimit të pensionit. Shërbimi është i vlefshëm vetëm për kategorinë e qytetarëve që përfitojnë pension.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

1. Dokument identifikimi. Kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin 'e-Albania').

**Hapat e procedurës**

1. Regjistrohuni si qytetar në portal.
2. Kërkoni shërbimin "Vërtetim pensioni".
3. Klikoni butonin "Përdor" për të parë dhe shkarkuar vërtetimin e përfitimit të pensionit.

- Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit: Menjëherë;
- periudha e vlefshmërisë, pa afat.
- Kostot: Pa pagesë

### CERTIFIKATA PERSONALE

Shërbimi elektronik "Certifikatë personale" në "e-Albania" ju mundëson të shikoni dhe verifikoni të dhënat personale, duke marrë ekstrakt nga regjistri i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në formën e certifikatës personale.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

1. Dokument identifikimi: Kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portal).

**Hapat e procedurës**

1. Identifikohuni si qytetar në portalin "e-Albania"
2. Zgjidhni shërbimin "Certifikatë personale".
3. Klikoni butonin "Përdor"

- Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit: Menjëherë
- Kostot: Marrja e informacionit nëpërmjet portalit "e-Albania" është pa kosto. Në qoftë se ju i drejtoheni gjendjes civile për marrjen e këtyre informacioneve, kosto është 50 lekë.

### MASAT E PATËRHEQURA TË PENSIONIT TË PLEQËRISË

- Ky shërbim elektronik bën të mundur publikimin e masave të patërhequra të pensionit të pleqërisë.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

- Dokument i identifikimit të kërkuesit: kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania").

**Hapat e procedurës**

- Për të përdorur shërbimin duhet të regjistroheni si qytetar në portal dhe të aksesoni shërbimin, i cili hapet menjëherë kur klikoni butonin "Përdor" në krah të tij.
- Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit: Menjëherë.
- Kostot: Pa pagesë.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,604,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapraksisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të kondicionimit në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 17 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 9,000,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapraksisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 20 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Drejtuesja e INAS: Si funksionon procedura për shqiptarët që kanë punuar në Itali

# Pensionet e pleqërisë, si bëhet verifikimi i kontributeve

## *Beskida Aliaj: Ja kriteret dhe dokumentacioni*





Beskida Aliaj, drejtuese e Patronatit INAS Albania

Voltiza Duro

Tashmë të gjithë ata që do të aplikojnë për të përfituar pension pleqërie, mund të drejtohen pranë Patronatit INAS Albania për të bërë verifikimin e kontributeve. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Beskida Aliaj, drejtuese e këtij patronati tregon se në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, janë në gjendje të verifikojnë në arkivin e këtij institucioni, të gjitha periudhat e punës dhe kontributeve të derdhura. Ajo, gjithashtu, thekson edhe kushtet që duhet të përmbushin kandidatët e dokumentacionin që duhet të dorëzojnë për të përfituar nga ky pension. Drejtuesja e INAS, bën me dije se verifikimi i periudhave kontributive kryhet nga ky patronat edhe për shqiptarët që kanë punuar e jetuar në Itali.

**Si duhet të veprojë një individ që do të aplikojë për pension pasi ka punuar me kontribute, por nuk di me saktësi periudhat e punës?**

Për sa i përket shqetësimit për mungesën e librezës së punës, në këtë aspekt një ndihmë të rëndësishme e ofron Patronati INAS. Çdokush mund t'i drejtohet patronatit për të pasur konfirmim për periudhat e punës e të kontributeve të derdhura në të gjithë institucionet dhe ndërmarrjet ku ka punuar. Bazuar në marrëveshjen që INAS ka lidhur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri, ISSH, Patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontributive, në arkivin e këtij institucioni.

**Sa zgjasin procedurat për marrjen e përgjigjes?**

Duke qenë se arkivi i vjetërsisë së punës është në proces informatizimi, por ende nuk ka përfunduar, për përgjigjen do të duhet një kohë prej më pak se 1 muaj.

**Si procedohet me rastet kur i interesuari që do të aplikojë për pension, ka informacion të saktë mbi periudhat e kontributeve?**

Në rast të kundërt, pra kur i interesuari i di me saktësi periudhat e punës e të kontributeve të derdhura, në çastin e aplikimit për pension, përpilon formularin PERIUDHA SIGURIMI.

**Cilat janë të dhënat që duhet të përfshijë në këtë formular?**

Në formularin Periudha Sigurimi, kandidati që do të aplikojë për pension duhet të shënojë në rend kronologjik, të gjitha të dhënat mbi periudhat kontributive. Këto të dhëna përfshijnë: ndërmarrjen, institucionin, ish-kooperativën apo subjektin ku ka punuar individi. Gjithashtu, duhet të specifikojë detyrën që ka kryer, datën e fillimit dhe të largimit nga ai vend pune si dhe vërejtjet.

> "Në formularin "Periudha Sigurimi", kandidati që do të aplikojë për pension duhet të shënojë në rend kronologjik, të gjitha të dhënat mbi periudhat kontributive.

**Duhet të jetë domosdoshmërisht vetë i interesuari gjatë aplikimit?**

Për aplikimin për pension, sipas mundësisë që kandidatët kanë, ose mund të paraqiten vetë, ose të prokurojnë një të afërmin e tyre. Të gjitha procedurat mund t'i kryejë edhe me ndihmën e drejtpërdrejtë të INAS-it, pa asnjë pagesë.

**Cilat janë kushtet e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë?**

Personat që kanë periudha sigurimi, kanë të drejtën e përfitimit të pensionit të pjesshëm të pleqërisë kur: plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 6 muaj plus me koeficentin e rritjes se jetëgjatësisë për gratë; kanë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi; janë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

**A mund të na jepni një shembull në lidhje me këtë?**

Nëse një person ka punuar 21 vjet me kontribute në Shqipëri e mbush moshën 60 vjeç e 6 muaj, atëherë do të përfitojë pension të pjesshëm pleqërie, që është i barabartë në përqindje me raportin 21 vjet që ka punuar, me 35 vjet që nevojiten për pension të plotë pleqërie, pra përfituesi do të marrë 60% të pensionit të plotë.

**Cili është dokumentacioni që nevojitet?**

Dokumentacioni që duhet të paraqisni është: fotokopje e kartës së identitetit, certifikatë e gjendjes familjare; certifikate martese për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune); dy fotografi; libreza e punës e në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës; vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj); diploma e shkollës së lartë për gratë, e cila konsiderohet vjetërsi pune. Gjithashtu aplikuesit, i nevojitet çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë; vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994. Ndërkaq, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive si dhe një fotokopje të librezës së pagimit të energjisë elektrike.

**Si bëhet verifikimi i periudhave kontributive në Itali?**

Patronati është në gjendje të verifikojë të gjitha periudhat kontributive, në arkivin e institucionit Instituto Nazionale Previdenza Sociale e thënë ndryshe INPS ose institucion ky analog me Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri.

**Sa zgjatin procedurat e verifikimit për ata shqiptarë që kanë punuar me kontribute në shtetin italian?**

Duke qenë se në Itali ky shërbim ofrohet i informatizuar, ne mund të futemi online në sistemin INPS meqë kemi akses dhe passwordet e ofruara nga vetë institucioni dhe i nxjerrim këto periudha të punës në Itali, për qytetarin shqiptar, për jo më shumë se 5 minuta dhe mjafton që qytetari të ketë me vete një kartë identiteti dhe një codice fiscale.

**Çfarë është ekstrakti i periudhave kontributive në Itali?**

Ekstrakti i periudhave kontributive është dokumenti që rendit të gjitha kontributet e bëra në INPS në favor të punëtorit. Ai përmbledh pagesat e punës, figurative dhe reduktuese, të ndara sipas ndërmarrjeve ku punonjësi është i regjistruar. Me ekstraktin e periudhave kontributive punonjësit mund të kontrollojnë rregullsinë e kontributeve të paguara nga ata vetë ose punëdhënësit e tyre për të sinjalizuar edhe ndonjë mosakordance me INPS.

**Si bëhet ndarja e sigurimeve shoqërore në shtetin fqinj për shqiptarët?**

Deklarata e Pensionit detajon të dhënat personale të punonjësit dhe, përmbledhur në një tabelë, përfitimet e sigurimeve shoqërore të ndara në: periudhën e referencës; llojin e kontributeve, pra të punësuar, zejtar, tregti, shërbim ushtarak; shpërblim ose të ardhura, referencat e punëdhënësit si dhe kontribute të dobishme të shprehura në ditë, javë ose muaj, si për llogaritjen e pensionit, ashtu edhe për arritjen e të drejtës.

### KUSHTET E PËRFITIMIT TË PENSIONIT TË PJESSHËM TË PLEQËRISË:

- Plotësojnë moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç e 6 muaj plus me koeficientin e rritjes së jetëgjatësisë për gratë;
- Të kenë jo më pak se 15 vjet periudha sigurimi dhe jo më shumë se 35 vjet periudha sigurimi;
- Të jenë tërhequr nga veprimtaria ekonomike

### DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQITNI:

- Fotokopje e kartës së identitetit
- Certifikatë e gjendjes familjare
- Certifikatë martese për gratë (për efekt të mbiemrit të kohës së vajzërisë, me të cilin mund të ketë periudha pune)
- Dy fotografi
- Libreza e punës (në mungesë të saj plotësimi i rubrikave të punës);
- Vërtetim i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuesit meshkuj)
- Diploma e shkollës së lartë për gratë (e cila konsiderohet vjetërsi pune)
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton qenien në punë;
- Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip (nëse ka punuar dhe ka derdhur kontribute për periudhat pas datës 01.01.1994)
- Çdo dokument tjetër justifikues, që vërteton pagën ose derdhjen e periudhave kontributive
- Fotokopje e Librezës së pagimit të energjisë elektrike



## Analiza e ministrit të Financave dhe Ekonomisë

# Investimet e huaja direkte, 1.1 miliardë lekë

Investimet e huaja direkte arritën në 1. 1 miliardë lekë gjatë vitit 2016, duke shënuar një rekord për ekonominë shqiptare. Shifra u bë e ditur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj mori pjesë dje në eventin "Tirana Bussines Matching", të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. "Investimet e huaja direkte janë një nga instrumentet kryesore në mbështetje të rritjes ekonomike në Shqipëri dhe rajon. Në vitin 2016 Shqipëria shënoi një rekord të rritjes me 1.1 miliardë",-theksoi ministri Ahmetaj. Gjithashtu, ministri nënvizoi faktin se ekonomitë tona në rajon vijojnë të performojnë nën potencial, të cilat kanë probleme me gamën e eksporteve. "Ekonomitë tona e kanë gamën e eksporteve të ngushtë, që do të thotë që nga një krizë në sektor, kalon në krizë ekonomike dhe krizë në bilancin e pagesave". Ministri Ahmetaj u shpreh se sfida nuk është kalimi në një nivel numerik, por në një nivel të orientuar drejt rritjes së cilësisë. "Rritja e produktivitetit është një sfidë që kërkon politika afatgjata. Të gjitha rritjet e ekonomive të rajonit kanë qenë shumë të ngadalta në rritjen e produktivitetit. Kemi avantazh koston e ulët, por kemi disavantash mes aftësive dhe kërkesës në treg"-tha Ahmetaj. Gjatë fjalës së tij në konferencë ministri Ahmetaj theksoi se synimi i Ministrisë së Financave është krijimi i një tregu të hapur, të konsoliduar dhe të thjeshtë për investitorët e huaj, të cilët sipas Ahmetaj janë faktori kyç në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. "Qasja jonë është krijimi i një tregu të hapur rajonal, treg i hapur, i konsoliduar dhe i thjeshtë për investitorët e huaj",-u shpreh Ahmetaj.

## Mblidhet Këshilli Ekonomik Kombëtar, përcaktohen prioritet për vitin 2018

# Rama: Rritje me 42% të investimeve publike

## *Ahmetaj: Prioritet arsimi, turizmi, shëndetësia e infrastruktura*



Ornela Manjani

Investimet publike do të rriten me 42% vitin që vjen në raport me 2017, raporton kryeministri, Edi Rama në mbledhjen e Këshillit Ekonomik Kombëtar. Sipas Ramës, gjatë 2018 parashikohet edhe një rritje e Prodhimit të Brendshëm Bruto në 6.3% ose me 26 miliardë lekë, jo vetëm si rezultat i rritjes ekonomike, por edhe i luftës ndaj informalitetit. Për të nxitur investimet në sektorin e turizmit, investitorëve që ndërtojnë komplekse me 4 dhe 5 yje do t'ju hiqen tri taksa. Një nisëm kjo që vjen pas uljes së TVSH-së nga 20 në 6%. Gjatë mbledhjes së Këshillit Ekonomik Kombëtar, ministri i Financave Arben Ahmetaj është ndalur në rëndësinë që do t'i kushtohet bujqësisë dhe shëndetësisë. Kështu shëndetësia do të ketë një rritje fondesh me 5.6 %, ndërkohë që për bujqësinë do të aplikohen skemat e mbështetjeve financiare në bazë të projektit IPARD në vlerën e 93 milionë euro për tre vjet.

**TAKIMI**

Është mbledhur dje për herë të parë, që nga krijimi i qeverisë "Rama 2", Këshilli Ekonomik Kombëtar ku në qendër të diskutimit ka qenë buxheti për vitin 2018. I pranishëm në Këshill, kryeministri Rama tha se do të ketë një rritje më 42% të investimeve publike dhe se buxheti do të garantojë ecurinë e reformave themelore që i quajti ai. "E rëndësishme në qëndrimin tonë është që investimet publike do rriten me 42 % ndaj 2017 dhe buxheti do garantojë ecurinë e reformave themelore, që nga ajo në drejtësi te reforma e administratës publike, administrative territoriale dhe reforma ujit. Po ashtu, parashikimi për të ardhurat, të cilat sipas projeksioneve tona do të tejkalohen, është që në 2018 të kemi një rritje 6.3%.",-tha Rama. Kryeministri tha ndër të tjera se buxheti është katërfishuar në raport me 4 vjet më parë. "Dëshiroj që përmes jush të përsëris apelin tim për të gjithë sipërmarrësit që të na vënë në provë, që të përdorin avokatin e tyre brenda në qeveri që është ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen. Sot kjo temë i kushtohet mbledhjes së buxhetit, një teme madhore. Rritja ekonomike ka një përshpejtim relativ, në raport me një vit me parë. Sot jemi në një rritje katërfish nga ajo e katër vjetëve më parë. Ne do të vazhdojmë t'i thellojmë reformat, të bindur se është e vetmja rrugë",- tha Rama. Rama e vuri edhe njëherë theksin te përmirësimi i komunikimit me të gjithë sipërmarrësit, të vegjël a të mëdhenj. Kreu i qeverisë tha se ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen, Sonila Qato, do të shërbejë si avokate për sipërmarrjen, duke u siguruar që çdo kompani të mos cenohet nga askush. "Dua të nënvizoj se jemi të prirur të përmirësojmë komunikimin me sektorët e tregut. Ndërveprimi mes nesh mund të jetë më efektiv dhe efikas. Jemi këtu për të mbrojtur botën e sipërmarrjes, për të qenë avokatë të saj, për të vënë në lëvizje përmes Ministrisë së Shtetit, ministrin përkatës për çdo lloj problemi. Kemi trajtuar 49 raste komunikimi të drejtpërdrejtë të një sipërmarrje me qeverinë, disa janë zgjidhur disa janë në proces.",-tha Rama.



**DEKLARATA**

"Jemi këtu për të mbrojtur botën e sipërmarrjes, për të qenë avokatë të saj, për të vënë në lëvizje përmes Ministrisë së Shtetit, ministrin përkatës për çdo lloj problemi. Kemi trajtuar 49 raste komunikimi të drejtpërdrejtë të një sipërmarrje me qeverinë, disa janë zgjidhur disa janë në proces.", - tha Rama.

# Paralajmërimi i Bankës Botërore BB: Investimet e huaja do të bien




Banka Botërore paralajmëron se investimet e huaja direkte në Shqipëri do të shënojnë rënie të ndjeshme në dy vjetët e ardhshëm. Në raportin e fundit mbi zhvillimet ekonomike në Europë dhe Azi, banka parashikon se fluksi i investimeve të huaja në Shqipëri do të bjerë nga 8.3 për qind e prodhimit kombëtar që është këtë vit, në 7 për qind vitin e ardhshëm. Por rënia pritet të jetë edhe më e madhe në vitin 2019, kur investimet e huaja direkte sipas BB do të zbresin në 5.6 për qind të prodhimit kombëtar. E shprehur në vlerë, kjo do të thotë se në dy vitet e ardhshme, investimet e huaja në ekonominë shqiptare pritet të ulen me rreth 300 milionë euro. "Burime zyrtare nga Banka Botërore thonë se parashikimi për rënien e investimeve nga jashtë lidhet me përfundimin e dy projekteve madhore, gazsjellësit Trans Adriatik dhe kaskadës së Devollit",-thotë TCH. Të dy këto vepra nga viti i ardhshëm pritet të ngadalësojnë vëllimin e investimeve, ndërkohë që në skenarin bazë të parashikimit nuk ka asnjë projekt tjetër të ri që mund të zëvendësojë efektin e tyre. Në katër vitet e fundit investimet e huaja direkte janë luhatur nga 8 deri në 9 për qind të prodhimit kombëtar, duke qenë një nga nxitësit kryesorë të gjallërimit të ekonomisë. Pritshmëritë për rënien e tyre e kanë çuar bankën në vendimin për të ulur edhe parashikimin e rritjes ekonomike për 2018 nga 3.8 për qind në 3.5 për qind.

### Dy javë më parë Berisha publikoi denoncimin e qytetarit dixhital

# Arrestohet Artan Dekovi, i dënuar me 8 vjet burg për një plagosje në vitin 2014


Vendi ku ndodhi plagosja në 2014-ën

**SHKODËR** - Një 45-vjeçar i shpallur në kërkim për tentativë vrasjeje është arrestuar dje nga policia e Shkodrës. Bëhet fjalë për Artan Dekovin, i cili më 10 tetor të këtij viti u përmend nga ish-kryeministri Sali Berisha në një status të tij në "Facebook". Sipas Berishës, qytetari digjital denoncoi rastin e Artan Dekovit, i cili nuk arrestohej për shkak se është djali i xhaxhait të shefit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në policinë e Shkodrës. 16 ditë pas këtij denoncimi, blutë e qytetit verior prangosën 45-vjeçarin, banues në lagjen "Dobraç". Ndërkohë, burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se Artan Dekovi është i dënuar me 8 vite burg për një ngjarje të ndodhur më 29 mars të vitit 2014 në qytetin e Shkodrës. Mësohet se Dekovi u shpall në kërkim më 30 mars të 2014-ës, pasi plagosi me armë zjarri shtetasin Anton Dakaj. Policia në atë kohë bëri të ditur se procedimi ndaj Artan Dekovit filloi sepse ky shtetas pas një konflikti të çastit për motive të dobëta, në një lokal "Bar- Bufe" në lagjen "Partizani" Shkodër, qëlloi me armë zjarri 42-vjeçarin Dakaj, banues në Shkodër. Në momentin kur ndodhi ngjarja, ky i fundit ishte duke pirë kafe me vëllain e tij në zonën e njohur "Rus". I plagosuri Anton Dakaj mori një plumb në këmbë, i cili i preku arterien kryesore. Ndihma e shpejtë e mjekëve bëri që ai të shpëtojë. Pavarësisht se i mbijetoi vdekjes, Dakaj mbeti invalid. Pas ngjarjes janë zhvilluar seancat gjyqësore dhe në përfundim, agresori Artan Dekovi u dënua me 8 vite burg. Vetëm pas 3 vitesh e gjysmë, në kërkim policor u bë e mundur kapja e 45-vjeçarit. "Me datë 26.10.2017 nga Sektori i Krimeve të Rënda në D.V.P. Shkodër, në bashkëpunim me forcat e Komisariatit të Policisë Shkodër, pas informacioneve të marra në rrugë operative dhe një operacioni të mirorganizuar, u bë e mundur kapja dhe ndalimi i shtetasit në kërkim: Artan Dekovi. Ndalimi i këtij shtetasi u bë pasi Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, ka vendosur masë sigurimi arrest në burg, me vendim nr. 51-2016-3890 datë 14.09.2016 me 8 vite burg, për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit".

**QYTETARI DIGJITAL**

"Përshëndetje z.Doktor, jam një oficer policie në Komisariatin e Policisë Shkodër. Nuk mundemi të japim informacion për një person në kërkim Artan Dekovi i dënuar me 12 vjet burgim, pasi është djali i xhaxhait të shefit të SHÇBA në Drejtorinë e Policisë Shkodër, Arben Dekovi. Ky person lëviz i armatosur në qytet dhe nuk e ndalon njeri, sepse kemi frikë nga shef Arbeni. Ju lutem publikoje, por anonim".

## Bledar Ara: Kërkoj drejtësi nga trupa gjykuese, të jenë asnjanës

# Prindërit "luftë" për kujdestarinë, babai i 7-vjeçarit: E ëma braktisi fëmijën për letra

### "Shkoi të takonte të afërmit në Belgjikë, nuk u kthye më"

Ina Allkanjari

I preva biletën bash këshortes për 15 ditë, për të takuar prindërit në Belgjikë dhe nuk u kthye më, braktisi fëmijën për letrat". Kështu është shprehur dje për "Gazeta Shqiptare" babai i fëmijës 7-vjeçar nga Shkodra, pas disa seancave gjyqësore me ish-bashkëshorten për kujdestarin e djalit të mitur. Pas skandalit të krijuar për pyetjen e 7-vjeçarit në ambientet e shkollës nga një trupë gjyqësore e Gjykatës së Apelit në Shkodër, Bledar Ara ka reaguar duke thënë se këto janë vendime të gjykatës dhe ai nuk mund të ndërhyjë. I shqetësuar për fatin dhe të ardhmen e fëmijës, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Bledari kërkon drejtësi nga trupa gjykuese. "Dua që gjykata të jetë asnjanëse", është shprehur ai.

**Zoti Bledar, kur u largua ish-bashkëshortja juaj nga Shqipëria?**

Ermira e braktisi fëmijën tonë që në moshën 2 vjeç e gjysmë, në dhjetor djali bën 7 vjeç. Kam rreth 4 vite që e rris dhe e edukoj i vetëm. Mamaja e tij u largua dhe nuk ka ardhur asnjëherë ta shohë djalin.

**Cila ishte arsyeja që zonja Ermira u zhvendos në një shtet tjetër?**

Unë me ish-bashkëshorten kishim një marrëdhënie të mirë. Ajo kishte dëshirë të vizitonte prindërit në Belgjikë. Për këtë arsye i preva biletën që të qëndronte 15 ditë pranë të afërmve të saj, por ajo nuk u kthye më. E prita 6 muaj, por nuk donte të vinte në Shqipëri. Ju luta që të kthehej për fëmijën, por nuk pranoi.

**Çfarë ndodhi më tej?**

Vendosa të vazhdoj jetën time dhe të kujdesem për djalin. 6 muaj pasi është larguar, bëmë divorcin. I interesonte më shumë e ëma se fëmija i vet. Të kishte qenë nënë e mirë, e kishim rritur të dy. Ndërkohë kam njohur dhe bashkëjetoj me dikë tjetër. Duhet të vazhdoj jetën time.

**Pse nuk vendosët të shkonit familjarisht në Belgjikë?**

Sepse i kishim mundësitë për të jetuar këtu, unë jam mirë ekonomikisht, kam jetën këtu, nuk kam pse largohem nga vendi im për të shkuar azilant në një shtet tjetër. Mund t'i ofroj një të ardhme të mirë djalit edhe këtu. I kam thënë hajde të jetosh në Shqipëri, në këtë mënyrë do e kemi të dy fëmijën afër. Unë e kam rritur djalin, tashmë është 7 vjeç, nuk mund ta kem aq larg, ku ishte e ëma deri tani?

**Djali juaj 7-vjeçar është pyetur në ambientet e shkollës nga një trupë gjyqësore e Gjykatës së Apelit. A jeni në dijeni se në Kodin e Familjes fëmijët pyeten nëse janë mbi 10 vjeç?**

Nuk e di, nuk e vendos unë, janë procedurat e gjykatës. Unë nuk mund të përzihem, dua vetëm drejtësi, dua që gjykata të jetë asnjanëse. Që nga momenti që kanë filluar proceset gjyqësore deri tani ish-bashkëshortja ime nuk ka ardhur asnjëherë në gjyq. Po t'i interesonte fëmija, kishte ardhur në Shqipëri, nuk kishte munguar në asnjë seancë.

**A ka pasur kontakt zonja Ermira me djalin që nga momenti që është larguar?**

Gjatë gjithë kohës ka pasur kontakt me djalin, nuk s'ia kam ndaluar asnjëherë, kanë biseduar në telefon. Ka njohuri për të ëmën, s'ia kam ushqyer asnjëherë që të mendoj keq për mamanë e tij. Unë s'ia kam mohuar kurrë fëmijën. Uroj që jepet një zgjidhje nga gjykata, të vijë e ëma të jetojë në Shqipëri, në këtë mënyrë mund ta kemi të dy djalin afër.


Bledar Ara, babai i fëmijës




**KUJDESTARIA E FËMIJËS**

"Kërkoj drejtësi nga trupa gjykuese. Dua që Gjykata e Apelit në Shkodër të jetë asnjanëse. Jam i shqetësuar për fatin dhe të ardhmen e djalit tim", është shprehur Bledar Ara, babai i fëmijës 7-vjeçar.

**SKANDALI**

"Është gjykata që vendos si do procedohet dhe për pyetjen e djalit për të ëmën nuk e vendosa unë. E vetmja gjë që unë kërkoj është të vendoset drejtësia. Të mos ma largojnë djalin. Dua më të mirën për të dhe unë mund t'i ofroj një të ardhme këtu në Shqipëri".

## SHKURT

### Aksident në Tiranë, makina përplas motorin, një i plagosur

**TIRANË** - Një aksident rrugor është shënuar mesditën e djeshme në kryeqytet. Ngjarja ka ndodhur në rrugën "Llazi Miho", në zonën e Kombinatit, ku janë përfshirë një automjet dhe një motor. Mësohet se makina ka përplasur motorin, duke i shkaktuar plagë të rënda motoçiklistit. Ky i fundit është dërguar në spital për të marrë ndihmën mjekësore, ndërsa policia vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

### Çështja "Doshi-Frroku-Bami", Gjykata e Lartë shpall moskompetencë

**TIRANE**- Gjykata e Lartë shpalli dje moskompetencë për çështjen "Doshi-Frroku-Bami". Deputeti Tom Doshi, ish-deputeti Mark Frroku dhe shtetasi Durim Bami akuzohen për "Kallëzim të rremë në bashkëpunim". Ky gjykim, sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të vazhdojë nga Krimet e Rënda, pasi me ndryshimet kushtetuese, Gjykata e Lartë s'ka më kompetencë. Prokuroria mban qëndrimin se vepra e "Kallëzimit në bashkëpunim" qëndron në faktin se të tre të pandehurit kanë fabrikuar prova të rreme, sikurse është videoja Doshi-Bami, në të cilën flitej për një skenar ekzekutimi në dëm të deputetit Doshi me porosi të Ilir Metës, në atë kohë kreu i Kuvendit. Për çështjen hetimore, e cila pas pretendimit të Doshit se Durim Bami ishte ndërmjetësuar për të kryer vrasjen e tij, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda u thirrën personalitete të sferës politike në vend, që nga kryeministri Rama, ish-kryeministri Berisha, Presidenti Meta, ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri dhe një sërë deputetësh.

## Veliaj: Kompanitë private të fillojnë porositë

# Modernizohet transporti publik, nis testimi i autobusit të parë elektrik

Ka nisur testimi i autobusit të parë elektrik, çka shënon një hap më tej drejt modernizimit të transportit publik në kryeqytet. I pranishëm në këtë ngjarje ka qenë edhe kryebashkiaku Erion Veliaj i shoqëruar nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjiknuri; ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Blendi Klosi si dhe ambasadori i Polonisë në Shqipëri, Karol Bachura. Kryetari i Bashkisë së Tiranës theksoi se me këtë teknologji, kryeqyteti po ndjek të njëjtin hap zhvillimi si dhe shumë qytete të zhvilluara në botë. Gjithashtu, ai u bëri thirrje kompanive që operojnë në fushën e transportit publik që të nisin sa më parë porositjen e autobusëve të kësaj teknologjie. Në të kundërt, ai paralajmëroi se Bashkia e Tiranës po mendon të krijojë një kompani publike të transportit urban, nëse kompanitë aktuale të transportit nuk do t'i përgjigjen këtij standardi. "Po ju them sërish, do të krijojmë një kompani publike të transportit, nëse operatorët private nuk do të na përgjigjen në këtë shkallë modernizimi. Nga testimet e ndodhura në SHBA në një dekadë, një autobus kursente 500 mijë dollarë karburant, ky është një investim që vlen", - u shpreh Veliaj. Ai garantoi se përveç kostove që mund të ketë fillimisht blerja e autobusëve të rinj, futja e kësaj teknologjie do të jetë një investim i favorshëm për të ardhmen dhe financat e operatorëve, kjo për faktin se ato do të punojnë me një kosto më të ulët. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi falënderoi kryebashkiakun Veliaj për ndërmarrjen e kësaj nisme, që kontribuon për një mjedis më të pastër. Edhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, përgëzoi Bashkinë e Tiranës për këtë hap të rëndësishëm të hedhur në fushën e transportit publik. Më tej, të pranishmit në këtë testim bënë një udhëtim me autobusin elektrik, duke parë nga afër mënyrën se si ai performon në trafikun dhe rrugët e kryeqytetit.

**DEKLARATA**
"Do të krijojmë një kompani publike të transportit, nëse operatorët privatë nuk do të na përgjigjen në këtë shkallë modernizimi. Nga testimet e bëra në SHBA në një dekadë, një autobus kursente 500 mijë dollarë karburant, ky është një investim që vlen" - tha Veliaj.


Erion Veliaj gjatë testimit të autobusëve elektrikë

## Adem Demushi: Kanë vjedhur plot 25 milionë lekë në kurrizin tonë

# Paraplegjikët protestojnë para derës së kyçur të shoqatës

## *Anëtarët: Po abuzojnë me fondet tona*

Voltiza Duro

Rreth 30 persona me status parapegjik protestuan ditën e djeshme para derës së mbyllur të shoqatës së Invalidëve të Shqipërisë, duke akuzuar kreun e tyre se po abuzon me fondet. Për më tepër se 4 orë, protestuesit kanë kërkuar edhe ndihmën e forcave policore për hapjen e derës. Më tej, ata kanë hyrë brenda ambienteve dhe policia ka shoqëruar në komisariat punonjësen e shoqatës që ndodhej brenda godinës, për ta marrë në pyetje në lidhje me çështjen. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Adem Demushi, anëtar i kësaj shoqate pretendon se kreu i 'Invalidëve të Shqipërisë', Ndrek Ismaili, në bashkëpunim me disa të tjerë ka abuzuar me plot 25 milionë lekë, që duhet të përdoreshin në ndihmë të kësaj kategorie. Gjithashtu, Demushi pretendon se kanë dashur të bëjnë edhe tregtimin e karrigeve me rrota brenda ambienteve. Që prej vitit 2001, shoqata e para-tetraplegjikëve është vendosur në objektin dykatësh në zonën e Laprakës në kryeqytet, me vendim të bashkisë, pasi ndërtesa ish- ndërmarrjes shtetërore administrohej nga kjo e fundit.

**Cila është arsyeja që ju protestuat?**

Prej vitesh në kurrizin tonë po bëhen pazare të pista nga Ali Plaka, Qerim Stojku e i plotfuqishmi Ndrek Ismaili, i cili është dhe kryetari i shoqatës sonë. Këto veprime abuzive i kanë kryer në bashkëpunim me koordinatoren Shpresa Spahiu. Kështu që pas thirrjeve tona të shumta, vendosëm të ngremë zërin për të drejtat që na takojnë.

**Ku kanë ndodhur abuzimet sipas jush?**

Një vit e gjysmë më parë, vetë Shpresa Spahiu me Ali Plakën pohuan se këtu po bëhet "kërdia", pasi plotësohen fatura fiktive për të mbuluar pislleqet që bëjnë me paratë. Vlera e fondeve me të cilat është abuzuar arrin vlerën 25 milionë lekë të vjetra. Shteti këto fonde i adreson për kategorinë tonë që të na vijë në ndihmë, por kurrë nuk janë përdorur nga ne. Madje, Ismaili dëshironte të shiste plot 3500 karroca me rrota me çmim minimal 1300 euro, duke folur në emër të shoqatës. Ne i kemi të gjitha të faktuara, nuk janë thjesht pretendime të kota.

**Kush e kishte kyçur derën e shoqatës?**

Koordinatorja e shoqatës, Shpresa Spahiu. Ajo i ka shndërruar ambientet e shoqatës sonë në hotel, e ka privatizuar. Tentuam të hynim sot, por ajo nuk përgjigjej, madje as thirrjeve të policisë. Pa përdorur dhunë, hartuam një procesverbal dhe hymë brenda, ku policia shoqëroi në rajon koordinatoren për ta marrë në pyetje në lidhje me çështjen.

**A i keni njoftuar instancat përkatëse mbi problematikën tuaj?**

Normalisht që i kemi njoftuar, madje për këtë rast kontaktova me zv.ministren Bardhylka Kospiri, e cila më tha që të mos ndërmarrim asnjë veprim të paligjshëm. Dhe ne s'do kryejnë asnjë akt të tillë. Edhe prokuroria është në dijeni të çështjes, por nuk na ka kthyer asnjë përgjigje sesi do të zgjidhet. Ne kemi denoncuar rastin edhe te Ministria e Financave. Kjo e fundit dërgoi një grup kontrolli auditi për të verifikuar këto fonde.

**Çfarë konstatoi ky grup auditi?**

Pas kontrollit, auditi nga Ministria e Financave arriti në konkluzionin se ka shkelje të mëdha financiare dhe e dërgoi çështjen për ndjekje penale. Por deri më tani nuk kemi parë asnjë veprim konkret për dënimin e abuzuesve. Mesa duket, gjithçka është mbyllur me korrupsion.

**Cilat janë kërkesat tuaja ndaj shtetit shqiptar?**

Kërkojmë nga shteti shqiptar që të bëjë drejtësi dhe të zbatojë ligjet, pasi ajo që po ndodh në kurrizin tonë është e pafalshme. Shoqata e tetraplegjikëve është një institucion shtetëror dhe askush nuk ka të drejtë të abuzojë me fondet tona.


Anëtarët e shoqatës duke protestuar

**KREU I SHOQATËS NUK PRONONCOHET**
I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", gjatë një bisede telefonike, kryetari i Shoqatës së Tetraplegjikëve të Shqipërisë, Ndrek Ismaili, nuk u prononcua në lidhje me protestën e ditës së djeshme. "I keni të incizuara materialet, dëgjojini", - tha ai.

**KONTROLLI**
"Pas kontrollit, auditi nga Ministria e Financave arriti në konkluzionin se ka shkelje të mëdha financiare dhe e dërgoi çështjen për ndjekje penale. Por deri më tani nuk kemi parë asnjë veprim konkret për dënimin e abuzuesve. Mesa duket, gjithçka është mbyllur me korrupsion", - u shpreh anëtari i shoqatës.

**ABUZIMET**
"Një vit e gjysmë më parë, vetë Shpresa Spahiu me Ali Plakën pohuan se këtu po bëhet 'kërdia', pasi plotësohen fatura fiktive për të mbuluar pislleqet që bëjnë me paratë. Vlera e fondeve me të cilat është abuzuar arrin vlerën 25 milionë lekë të vjetra", - tha Demushi.



## AKU asgjëson mbi 2 tonë mish, nuk plotësoheshin standardet

Mbi 2 tonë mish janë asgjësuar dje nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, pasi janë gjetur jashtë standardeve të përcaktuara për konsum. Në kuadër të aksionit të ndërmarrë për disiplinimin e therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit, AKU gjatë ditëve të fundit ka sekuestruar plot 2315,4 kilogramë mish, peshk dhe qofte në Qarkun e Tiranës. Asgjësimin e kësaj sasie e ka bërë në landfillin e Sharrës. Gjatë inspektimit, është konstatuar se kjo sasi mishi e magazinuar në frigoriferët e "Zoo Farm", nuk ka pasur vulën e veterinerit dhe certifikatën e origjinës. Gjithashtu, për të rritur standardet e sigurisë ushqimore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në njoftimin e tij ka bërë me dije se pas kontrolleve në të gjithë vendin, janë mbyllur plot 73 subjekte që nuk përmbushnin kushtet higjieno-sanitare. Ndërkaq, AKU siguron se kjo iniciativë e ndërmarrë ditët e fundit do të vazhdojë edhe në të gjitha fushat që lidhen me produktet ushqimore. Kontrollet do të përfshijnë jo vetëm zonat urbane në vend, po edhe ato rurale.

Specialistët sqarojnë: Shanset për të fituar, të barabarta për të gjithë

# Lotaria Amerikane, ambasada: Përzgjedhja, tërësisht e rastësishme

## "Ne nuk refuzojmë askënd, lexoni kriteret"

Voltiza Duro

Prej 18 tetorit kanë filluar aplikimet për Lotarinë Amerikane për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në Shtetet e Bashkuara. Në faqen zyrtare të ambasadës, kandidatëve u jepet mundësia për të pyetur në lidhje me çfarëdolloj paqartësie që mund të kenë. Shumë prej aplikantëve kanë dyshime se qyteti i Korçës është ai që fiton më shpesh, por ambasada në një sqarim që ka bërë ditën e djeshme në profilin e saj në "Facebook" shuan çdo dyshim. "Kushdo që beson se mund të kualifikohet, mund të regjistrohet për Lotarinë Amerikane dhe përzgjedhja është tërësisht e rastësishme", - sqaron ambasada. Edhe më parë, Departamenti i Shtetit Amerikan ka bërë me dije se seksioni konsullor apo ambasada nuk kanë asnjë rol në këtë përzgjedhje kompjuterike që bëhet në Kentucky dhe se shanset për të përfituar janë të barabarta si për korçarët, ashtu edhe për çdo shqiptar të lindur në qytetet apo fshatrat e tjera në vend. Çdo aplikuesi i vendoset një numër dhe kompjuteri në Qendrën Konsullore Kentucky përzgjedh numrat, pa asnjë dallim. Më pas shikohen aplikimet që kanë kryer regjistrim më shumë se një herë dhe skualifikohen. Pasi personi rezulton i përzgjedhur dhe i caktohet data e intervistës, është oficeri konsullor që shqyrton çështjen e tij/saj



dhe merr vendimin final për vizën, bazuar në kualifikimin dhe pranueshmërinë për vizë të aplikantit. "Ne ecim në bazë të rregullave dhe ligjeve që i gjeni në faqen tonë të internetit. Ne nuk refuzojmë askënd. Përkundrazi! Ne jemi shumë transparentë në punën tonë, bëjmë fushatë të gjerë sensibilizuese mbi kriteret e kualifikimit dhe gjithmonë kemi rekomanduar që të lexohen rregullat e kualifikimit përpara se të aplikojnë për lotarinë. Shpesh ndodh që nuk lexohen rregullat, nuk na kontaktojnë paraprakisht dhe në sportel kemi në person me arsimin që nuk e kualifikon, apo bën gabime në aplikim, për të cilin jemi të detyruar të zbatojmë ligjin. Dhe ne jemi këtu për të zbatuar ligjin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbi Imigracionin, edhe pse na vjen keq tek shikojmë që aplikanti refuzohet se nuk ka lexuar rregullat", - sqaron Ambasada Amerikane në profilin e saj në "Facebook".



### Manastirliu: Bashkë mund t'ia dalim

## Mëngjesi i veçantë i ministres me vogëlushët e shtëpisë së fëmijës

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ditën e djeshme e ka nisur në ambientet e shtëpisë së fëmijës "Zyber Hallulli" në kryeqytet. Ajo ka përzgjedhur fëmijët e grupit më të vogël të kësaj qendre të kujdesit social. Ministrja, pasi i ka ndihmuar në përgatitjen e mëngjesit, ka qëndruar me vogëlushët duke e cilësuar këtë takim si shumë të veçantë për të. Në faqen e saj në rrjetin social "Facebook", Manastirliu është shprehur e kënaqur dhe ka publikuar fotografitë me fëmijët. "Gëzuar me qumësht! Mëngjes i veçantë sot me Lindorin, Marinën, Seldin, Ilirjanin, Jurgenin, Samantën, Beltisën dhe Olivian në familjen e madhe tek 'Zyber Hallulli'", - shkruan ministrja. Në këtë mëngjes të veçantë, ajo ka qëndruar me vogëlushët e ka biseduar me ta duke iu përcjellë sa më shumë përkujdesje e ngrohtësi. "Tani gati për shkollë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkë mund t'ia dalim", - shkruan më tej Manastirliu.



IN MEMORIAM

Takimi me Sofi Shliman, kurimi, studimet e poezitë në dorëshkrime kryepërkthimet në fletorka

# LASGUSH PORADECI

# Në ditarë e letërkëmbime të panjohura

Fatmira Nikolli

***Shënim i Lasgushit në një copë letër.***

*Dhimitër Pilikës, t'i përgjigjem që më tha: "kam vënë re se ti Lasgush, je shumë modernist: s'përdor emra mitologjike". Unë Lasgushi nuk kam përdorur kurrë në poezinë time emra mitologjike (greke ose romake), jo se jam modernist, as se jam modern, po se dua të jem me ndjenja, me shprehje të përjetëshme, d.m.th përgjithërisht të njerëzishme, humane, të kupturashme dhe jo se dua të jem modern në poezi. Poezia s'ka as modernizmë as mitologjizmë. Edhe Gëteja, Shileri përdorin "Amor", "Venus", "Zeus", etj - sa keq! Përdorin edhe gjer më sot poetë të Europës - edhe Asdreni. Shumë keq. Ç'kërkon mitologjia greke dhe romake në poezinë e Gëtes, të Shilerit? Të Europës, të Shqipërisë? Kush i kupton fjalët mitologjike? Veç ndonjë specialist i antikitetit. Lexonjësi do kuptuarshmëri, jo specialshmëri. Lasgush*

*Mund të përdorim, p.sh., fjalën indike Kamadeva, po duhet t'i-a shpjegojmë atypëraty lexonjësit, t'i themi se "Kamadeva" në mitologjinë indike është zoti i dashurisë - dhe kuptimi për lexonjësin është imediat. Lasgush.*

***(Pjesë nga ditari)***

Në një ditar ai shënonte me datë çdo takim, çdo men dim, çdo emocion. Në një prej fletëve shënon: "Sot, takova Moikom Zeqon. Pagoi ai. Pimë fërnet Branka". Fërneti qe ruajtur që nga koha e luftës në turizmin e qytetit, e për ta porositur të dilte nga qilarët e nëndheshëm nga strukeshin kujtimet e moteve të tjera, duhej të ishte vetëm Lasgushi. Në dorë mbante konen e tij, në dorën tjetër shkopin dhe i thërriste drejtorit të turizmit, një gotë fërnet nga ai. "Ju të rinjtë shkruani vargje, por poeti jam unë", e thoshte, por pa mendjemadhësi. E kishte bindje dhe kishte të drejtë.

***

Në 30 nëntor 2017 mbushen plot 30 vjet nga vdekja e Lasgush Poradecit. Ishte 88 vjeç dhe kishte lindur në 27 shtator 1899, 1 vit para se të hynte shekulli i ri a para se të mbyllte sytë Naim Frashëri. Moikom Zeqo, vëren se jeta e Lasgushit është shumë e çuditshme. "E denjë për penën e Stefan Cvajgut që ka qenë mjeshtër për të përshkruar jetë të tilla të trazuara".

Lasgushi,-thotë Zeqo,-ka lindur në një familje atdhetare. Babai i tij ka qenë njeriu që hapi shkollën e parë shqipe në Pogradec, menjëherë pas asaj të Korçës. Ka qenë familje intelektuale dhe ai është rritur në këtë atmosferë, atë të librave shqip. Më 1909 shkolla në Pogradec mbyllet, dhe Lasgushi ende i mitur, në moshën 10-vjeçare detyrohet të shkojë për të vazhduar një gjysmë gjimnazi, në Manastir në Maqedoni në gjuhën rumune. Pas këtij dyvjeçari, kthehet në Pogradec dhe shkon me dëshirën e babait, në një lice fretërish francezë në Greqi. Nga mosha 16-vjeçare deri në moshën 20-vjeçare ka qenë në Athinë, ku ka mësuar frëngjisht, greqisht e ka lexuar poetët e mëdhenj francezë, si Bodlerin. Moikom Zeqo thotë se ka parë edhe përkthime nga Bodleri, dhe dorëshkrime poezish në frëngjisht.

## Moikom Zeqo: Një libër i ri studimor për 30-vjetorin e vdekjes




Lasgush Poradeci

**LASGUSHI NË RINI**

Njohës i shqipes, rumanishtes, frëngjishtes, greqishtes, Lasgushi në moshën 18-vjeçare ishte poliglot.

I ati i vdes dhe i ndërpritet ndihma nga ana ekonomike. Lufta e Parë Botërore është në të mbaruar dhe ai e gjen veten të sëmurë nga tuberkulozi i kockave, një sëmundje që e ka torturuar gjithë jetën. Me nismën e vet, ai shkon dhe takon Sofia Schlimanin, gruan e famshme greke të Henrik Shlimanit, zbuluesit të Trojës dhe kulturës Mikenase(kërkimin për Trojën e pat nisur vetëm nga çfarë kishte thënë Homeri). Pas vdekjes së të shoqit, ajo kishte ngritur një sanatorium, një pavijon i të cilit, ishte pa pagesë, vetëm për të varfrit. "Lasgushi është takuar me Sofinë dhe ky i ka bërë shumë përshtypje asaj. Ka jetuar dy vite në Sanatorium pa pagesë".

Në moshën 20-vjeçare, shkruan poezitë e para dhe bën vizatimet e para. Pas kësaj moshe, në Bukuresht nis studimin për pikturë ndërsa ndjek edhe shkolla të tjera, si Konservatori i Muzikës, i Drejtësisë, i Letrave. Më 1924 merr një bursë nga qeveria e Fan Nolit për të studiuar gjermanistikë dhe lingusitikë në Grac të Austrisë.

Më 1933, është ndër të parët shqiptarë që doktorohet me një tezë që ka të bëjë me Emineskun. Ndërkaq, ka botuar poetikë më 1933 dhe më 1937- të dytin me ndihmën e Mitrush Kutelit. Me kthimin në Shqipëri, Lasgushi emërohet si profesor i bukurshkrimit dhe vizatimit.

Pas çlirimit punon pak kohë në Institutin e Shkencave dhe më pas ka qenë përkthyes deri në moshën 75-vjeçare, në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Aty ka përkthyer një numër të madh poetësh. Për Zeqon, disa përkthime janë të një niveli shumë të lartë, si për shembull Bërnsi, që për profesor Moikomin është një ndër më të mirat në gjuhën shqipe prej të gjitha kohërave e krahasueshme, vetëm më 'Rubairat' e Omar Khajam, përkthyer nga Fan Noli. Ka përkthyer Majakovskin, Adam Miskieviçin, Lermontovin apo Hajnen.

**LIBRI**

Moikom Zeqo tregon për

# TIRANA LEXON

## Nisma dhe Festivali Ndërkombëtar kthen sytë nga letërsia

Njëfarë e premteje/ po sh koj të blej shpirtra/ (përty)/ në Naschmarkt/ tri herë pesëdhjetë cent/ përvëluar krah për krah,/ kjo kishë, mendova pas/ një nate të përgjumur/ ka diçka prej kurrille mbretërore/ qafë të gjatë fyt të kuq pala lëkure anash/. Këto janë vargje të poetes Andrea Grill, përkthyer nga Jonila Godole. Grill është një prej shkrimtarëve që vjen në Shqipëri në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë, që mbahet në Tiranë në datat 26-28 tetor. Organizuar nga IDMC me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Tiranës, Festivali Ndërkombëtar i Letërsisë në Tiranë (TILF) "Letërsi në lëvizje", ka ftuar autorë nga Shqipëria, Austria, Gjermania, Franca, Italia, Maqedonia, Suedia të dialogojnë me njëri-tjetrin, si dhe me publikun e gjerë, të rinj, studentë dhe të apasionuar pas letërsisë. Andrea Grill (Austri), Daniela Danz (Gjermani), Entela Tabaku Sörman (Suedi/Shqipëri), Jürgen Banscherus (Gjermani), Karl – Markus Gauß (Austri), Muriel Barbery (Francë),

Nikola Madzirov (Maqedoni), Roland Sejko (Itali/Shqipëri), Rudi Erebara (Shqipëri) dhe Thanas Medi (Shqipëri) janë atërorët veprat e të cilëve do të lexohen duke pasur të pranishëm shkrimtarët dhe përkthyesit e tyre.

Sipas drejtores së IDMC, Jonila Godole, moto e TILF 2017, "Letërsi në lëvizje" synon t'u japë autorëve mundësinë që të rrëfejnë rrugëtimin e tyre letrar dhe gjeografik: Letërsia në lëvizje, sfidat e migrimit, udhëtimi dhe mbërritja. "Leximet gjatë festivalit duan të hapin një dialog me publikun mbi këto tema dhe fate njerëzore, të cilat në 27 vitet e fundit kanë kaluar rrugëtime të brendshme e të jashtme, lëvizje demografike dhe migrim. Veçanërisht, publiku i ri shqiptar ka nevojë për këto perceptime që vijnë nga vende të ndryshme evropiane",-thotë Godole. Si



pas saj, festivali kthehet në një auditor të hapur mes të ftuarve dhe publikut për të reflektuar mbi letërsinë bashkëkohore dhe artin në tërësi përgjatë ndryshimeve politike, shoqërore dhe kulturore që ka kaluar Shqipëria. "Festivali, siç është krijuar traditë, hap siparin me maratonën e leximit #TiranaLexon në kafenetë letrare, klasat dhe biblioteka të ndryshme duke iu drejtuar të gjitha grupmoshave nga fëmijët te më të rriturit. Kombinimi i këtyre dy aktiviteteve shpresojmë të përmbushë shijet dhe pritshmëritë e një audience të gjerë letrare me shije të shumëllojta",-shton ajo.

Mes lexuesish dhe autorësh në sallën gjermane të Bibliotekës Kombëtare, Ministrja e Kulturës u bëri një ftesë të hapur mediave, por jo vetëm, të bashkëpunojnë më shumë mbi shqetësimin që ajo ndau me miqtë e librit, jo vetëm si ministre, por edhe si njeri i letrave.

"Kemi humbur 2 gjenerata lexuesish, por jemi në kohë për të edukuar ata që po vijnë. Duke qenë se jemi një shoqëri që jetojmë shumë virtualisht, rrjetet sociale dhe media, secili prej nesh, le t'i kushtojë 1 minutë në ditë takimit për një libër, kësaj propagande. Pini atë kafenë dhe bashkë me kafenë dhe një libër. Do t'i bëjmë një të mirë shumë të madhe vetes dhe fëmijëve",-tha ministrja Kumbaro.

Këtë vit nisma kushtuar librit "Tirana lexon", synon të çojë librin edhe në periferitë e krahasuetetit, si në bibliotekën e Bathores, por edhe të kthehet në një traditë leximi, që të mbushë me lexues


Asdreni (Aleksandër Stavre Drenova), Ernest Koliqi, Gjergj Fishta, Lasgush Poradeci (Llazar Sotir Gusho)

"GSH" se po shkruan një libër bazuar sipas tij në një material të pabesueshëm arkivor, që është marrë nga arkivi personal i poetit. Ai falënderon publikisht dy vajzat, Kostandinën dhe Marien, që ia kanë bërë të mundur. Është mbështetur edhe nga materiale të botuara siç janë korrespondenca me Mitrush Kutelin, Asdrenin dhe korrespondenca që ka me gruan e vet, Nafije Memën. E pabotuar prej këtyre, është korrespondenca me Eqrem Çabejn. Në vitin 2002, Zeqo pat botuar një libër-album me imazhe të vizatimeve e pikturave të Lasgushit, që e nismëtar i ekspozitës së atyre imazheve.

Kur e pyet Zeqon, se çfarë ka të panjohur nga ky material arkivor, thotë se të panjohurat janë shumë. "Lasgushi, ndryshe nga shkrimtarët e tjerë që kanë qenë të pakujdesshëm, për të cilët biografët kanë probleme, ai ka mbajtur ditarë të hollësishëm gati çdo ditë dhe ka shkruar tërë jetën e vet. Ditarët janë të pafund, ka shkruar çdo ngjarje që i ka ndodhur, çdo gjë që ka lexuar, çdo gjë që ka pasur, si reagim të emocioneve të veta",-thotë ai. Shton se qëllimi i tij ka qenë të jepte një paraqitje më të plotë deri tani për figurën e Lasgushit, mbi jetën e tij, jo një biografi strikte e pedante, por të japë në përgjithësi jetën e tij të çuditshme. Një tjetër ndalesë e Zeqos ka qenë studimi estetik i poezisë së tij. "Për Lasgushin janë shkruar shumë libra. Janë dy llojesh, studimorë, siç është ai i Rexhep Qosjes që ka qenë ndër të parët". Të parët libra studimorë, kanë qenë ata të Skënder Luarasit dhe Mitrush Kutelit, që e vlerësojnë shumë, por edhe studimi i një profesori, Krist Maloki, që boton një shkrim më 1938 me titullin "A asht poet Lasgushi Poradeci". Edhe pse kërkon të kritikojë apoeteozën apo lavdinë e tij, të mbivlerësuar, nga dituria që ka, edhe ai është i magjepsur nga Lasgush Poradeci,- thotë Zeqo.

Për të, një vlerësim të saktë nga ana estetike e poezisë së tij, deri tani, sipas Zeqos, nuk ka. Shton se janë bërë më shumë komente, ndërsa për poezitë mistike, janë pak. Ka një frymë panteiste universale. "E sheh frymën mistike në çdo anë të jetës, është poeti më i madh mistik pas Naim Frashërit. Poemat e tij nga niveli artistik janë të nivelit europain, të pakrahasueshme. As (Alfond) Lamartini që ka një poemë të famshme për liqenin, a për figura të historisë së Francës nuk e ka nivelin kaq të lartë mistik sa Lasgushi". Shton se ciklet e tij bazohen mbi parimin e therorësisë(sakrificës). E gjen atë te "Vdekja e nositit", një poemë e jashtëzakonshëm simbolike. "Nuk është 'Albatrosi' i Bodlerit, sepse albatrosi është i fuqishëm në ajër jo në tokë, ndërsa Lasgushi e ka më të fuqishëm. Ai merret me pelikanin, që në dialekt i thotë nosit. Ka një metaforë të krishterë për të- sipas së cilës, ku i kishte të vegjlit të



uritur, çan gjoksin dhe u jep mishin e vet zogjve të vet. Pra, ai është zogu që ushqen me mishtë tij të vetët".

**LETRA, DITARË, KUJTIME**

Lasgushi, ka pasur për Moikom Zeqon, dy binjakë të mëdhenj shpirtërorë: Eqrem Çabejn dhe Mitrush Kutelin. Letrat më Çabejn, tregojnë se si këta donin të ndryshonin tërë kulturën shqiptare, se si donin ta bënin kulturën të nivelit europian. Kjo ka qenë ambicia e të dyve. "Vëllai i dytë shpirtëror është Kuteli. Unë nuk di në pesë shekujt e letërsisë shqipe, që nga Buzuku e deri më sot, duke përfshirë edhe shkrimtarët e sotëm- një pjesë e të cilëve nuk kanë fare letërkëmbim, nuk kanë as marrëdhënie njerëzore, se vetëm zihen e shahen- të kenë nivele kaq të larta epistolare. Lasgushi, Eqremi dhe Kuteli janë shkrimtarë të mëdhenj të epistolarit shqip. Janë shembuj se si mund të shkruhen letrat mes miqve të nivelit të lartë intelektual. Janë të nivelit të lartë europian e këtu unë jam ndalur gjatë, se si shkruanin ata",-thotë Zeqo. Ka po ashtu edhe letrat me të shoqen, Nafijen, letra të bukura e të çuditshme,-thotë profesori.

Te letrat me Çabejn, kuptohet se janë dhe jetojnë si djem të kohës, visheshin njësoj, mendonin njësoj, janë pothuaj të binjakëzuar në shpirt dhe mendje. Flasin për kulturën, filozofët, flasin për të dashurat e tyre- janë njerëz tipikë europianë të viteve 1930.

Në libër, ai boton edhe disa shkrime të pabotuara të Lasgushit që lidhen me pikturën dhe poezinë si i mendon ai. Një tjetër gjë e re. Janë poezitë e pabotuara të përkthyera prej Lasgushit, shkruar nga Nikolaos Laneu.

**RAPORTET ME REGJIMET DHE KUJTIMET ME TË**

I pyetur pse ka qenë aq i tërhequr poeti, për Moikom Zeqon, Llazar Gusho ka qenë krejt indiferent në raport me regjimet në vendin tonë. "Është e vërtetë që gjatë pushtimit të Shqipërisë 1939-1944 anon nga antifashistët, sepse boton dy balada për dy dëshmorë të Luftës Antifashiste, Reshit dhe Nikolla Çollaku. Janë dy poema të gjata, por nuk ka pasur entuziazëm politik. Ai përgjithësisht ka qenë njeri i vetmuar. Jetonte 6 muaj në Pogradec e 6 muaj në Tiranë".

Zeqo e ka njohur personalisht Lasgushin. 30 vjet prej ndarjes nga jeta të poetit, studiuesi që po përgatit një libër për të, kujton edhe takimet. "E kam njohur nga afër. Më vjen mirë që në ditarët e tij, unë jam mbase shkrimtari më i cituar". E kujton si njeri të çiltër, por jo naiv. "Shumë i ditur. Lexonte pa pushim. E kam njohur kur lexonte Kantin. Kemi bërë edhe biseda për të, por jo biseda politike. Për poetët gjermanë të viteve 1939 kemi folur edhe për poetë të tjerë që ai ka përkthyer". Kanë folur edhe për "Zambakët" e polakut Miskieviç, për fjalët e gjuhës sanskrite. Janë takuar për herë të parë më 1972, kur Zeqo ishte gazetar i "Dritës", më pas e pat takuar në shtëpinë e tij, pasi Zeqo njihte bashkëshorten e tij Nafije Mema, që ishte nga Durrësi. Nafija, pat qenë pjesë e konkursit për abetaren duke marrë vendin e dytë dhe madje pat bërë edhe një libër se si mund të mësohet sa më mirë abetarja, duke pasur një qasje didaktike.

E pyes, si ishte në raport me të rinjtë. "Shumë i sjellshëm",-kujton Zeqo. "Nuk kishte lidhje me poezinë e realizmit socialist. Nuk kishte vlerësim për poetët e shkrimtarët e realizmit socialist. Thoshte se 'poeti jam unë, ju bëni vargje'. Fliste për Hanjnen e Gëten, tregonte ngjarje e lexime për poetët klasikë". Mban mend që kanë folur edhe për Mikelanxhelon e Rafaelon, ai e pëlqente pikturën klasike, por jo për pikturën moderne, pasi vlerësonte thjeshtësinë.

# Orikum, aty ku modernia pikëtakohet me lashtësinë

Nga Luan Rama

Orikos, Orikum, një vend legjendash. Një sit arkeologjik i panjohur nga publiku i gjerë, jo vetëm për shkak të pozicionit të tij gjeografik, disi të fshehur në gjirin e Karaburunit, por për më tepër nga përdorimi aty i një zone ushtarake në gjysmën e dytë të shekullit XX. Arkeologu Saimir Shpuza në konferencën e mbrëmshme me shoqatën "ALBANIA", na foli gjatë për këtë sit arkeologjik dhe bazë të vjetër ushtarake të antikitetit, si dhe për burimet antike rreth saj, nga ato helenistike e më pas romake, veçanërisht gjatë luftës së Cezarit e Pompeut në brigjet shqiptare, kur Cezari zbarkoi pikërisht në Orikum për të ndjekur kundërshtarin e tij Pompée drejt Dyrrachiumit, siç e tregon ai në "Guerres Civiles". Saimir Shpuza i ka filluar gërmimet në këtë sit në vitin 2007, vonë padyshim, pasi atëherë siti sapo u çlirua disi nga tutela ushtarake, çka urojmë të çlirohet plotësisht për ta bërë këtë sit një nga vendet e preferuara të një turizmi të ardhshëm internacional. Gërmimet vazhdojnë me një ekip shqiptaro-zvicerian dhe ato janë mjaft premtuese, nga viti në vit, pasi nga imazhi i të ashtuquajturit "teatër antik", tashmë me zgjerimin e gërmimeve, na sjell mesa duket imazhin e një "agoraje" të mundshme, të një fontane antike apo të një vendi kulti antik mjaft të rëndësishëm, rreth të cilit zhvillohej jeta e këtyre banorëve të hershëm, emrat e të cilëve padyshim një ditë do të na bëhen të njohur, bashkë dhe me historitë e tyre. Libri i Pausanias, historianit grek që flet për Ilirinë ka humbur, çka do të dinim diçka më shumë për atë kohë. E megjithatë, Orikos-Orikum nga romakët, mbetet një vend historie e legjendash, një vend që të frymëzon për nga pozicioni i tij me kodrinën që ngrihet dhe atë imazh mahnitës që shohim nga lart, çka u jep krahë përfytyrimeve tona. Në vitet që vinë, padyshim që Saimir Shpuza me ekipin shqiptar dhe miqtë e tij arkeologë zvicеranë (Consagra), do të na befasojë me gjetjet e reja që padyshim kërkojnë një mbështetje aktive dhe të madhe nga qeveria; do të na zbulojnë fytyrat e qytetarëve të lashtë, bashkiakëve, strategëve ushtarakë, fytyrat e perëndive, siç dëshmon ajo kokë e Afërditës që prehet në muzeun e Vlorës, objekte këto që shumë shpejt duhet të zënë vend në një shtëpi-muze të këtij siti. Pinjollët e familjes Vlora që i ruanin me shumë fanatizëm këto objekte, çka ishin një shenjë qytetërimi për ta, me siguri e dinin se një ditë ato do të gjenin vendin e tyre në qytetërimet moderne. Për Orikumin padyshim në vitet e ardhme do të flitej akoma më shumë, ashtu siç është folur për Apolloninë, Butrintin, Komanin, etj.



Siti Orikos-Orikum (i themeluar që në shekullin VI p.e.s.) është sigurisht një perlë e fshehur, e cila shumë shpejt do të zgjohet nga letargjia e shekujve. Një perlë e zbukuruar dhe në kohën bizantine me kishat përreth. Gramata, dy hapa pranë është një parantezë e mrekullueshme dhe joshëse për turistët për të kujtuar kohërat e piratëve të detit dhe udhëtimin e famshëm të basileut Paleolog, rrugës kur kthehej për në Kostandinopojë duke lënë mbishkrimin e famshëm. Duke vështuar mbrëmë Saimirin, dhe gruan e tij arkeologe Etleva Nallbani, papritur, atë e pyeta: Si është jeta e një çifti arkeologësh? - Pasionante dhe e vështirë! - më tha duke qeshur ai, me një lumturi që shprehte gjithë qenia e tij. Agata Kristi kishte fat në vitet '30 që shkonte pas burrit të saj arkeolog në shkretëtirat e Irakut e Sirisë në kërkim të qytetërimeve të vjetra. Saimiri dhe Etleva detyrohen ta ndajnë jetën e tyre në një trekëndësh të çuditshëm: Komani, Sarda dhe Lezha në veriun shqiptar, Orikos-Orikum në jugun shqiptar dhe Parisi, ku rritet pinjolli i tyre. Jetë pasionante padyshim në këtë trekëndësh malli ku pikëtakohet moderniteti me lashtësinë.



# Dëbimi i familjes shqiptare, Ministria e Integrimit në Gjermani: Veprim i nxituar

**GJERMANI**- Ministria e Integrimit ka reaguar sa i përket veprimit të nxituar që kanë ndërmarrë autoritetet e Gjermanisë ndaj familjes kosovare. Pak muaj më parë një familje kosovare, nëna bashkë me djalin e saj 10 vjeç, u dënuan nga Gjermania, Ministria e Integrimit të këtij vendi ka pranuar veprimin e nxituar të autoriteteve. Ngjarja në fjalë u regjistrua në Qarkun Eifel në landin e Rheinland-Pfalz. "Volksfreund.de" shkruan se sipas ministrisë, më e përshtatshme do të ishte që nënës t'i jepej një leje qëndrimi e përkohshme diskrecionale. Kjo do të ishte rruga më e mirë për të shpëtuar familjen nga transferimi. Pas vdekjes së babait, nga i cili varej e drejta e qëndrimit, në Gjermani kishte mbetur vetëm djali 17-vjeçar, i cili ishte duke vazhduar shkollën për elektroteknikë. Autoritetet për të huaj në nivel të qarkut kanë argumentuar se qëndrimi i tij në Gjermani nuk nënkuptonte se në mënyrë automatike duhet të rrinë edhe anëtarët tjerë të familjes. Por, qarku nuk do të pengojë vizitat e ndërsjella mes të anëtarëve të kësaj familjeje. Kështu, motra më e madhe e 17-vjeçarit do të lejohet që të shkojë në Gjermani gjatë verës së ardhshme për të nisur shkollën profesionale. Ky është rasti i dytë i konfliktit mes të qarkut të Eifelit dhe Landit 16. I pari ndodhi kur Ministria e Integrimit i kishte siguruar një familjeje libaneze prej shtatë anëtarësh qëndrimin në Gjermani, përkundër vendimit refuzues të qarkut dhe Gjykatës Administrative të Trierit.

"Vazhdoni luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit"

# "Marrëveshja për demarkacionin, kusht për liberalizimin e vizave"

## Shmid: Kryeni reformat që vendi të ecë drejt BE-së

Egla Xhemali

**KOSOVË**

Ratifikimi i Marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi mbetet kusht që duhet plotësuar sa më parë, në mënyrë që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet lëvizja pa viza në zonën Shengen", ka deklaruar sekretarja e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Helga Schmid. Këto komente ajo i ka bërë në Prishtinë gjatë një konference për media e shoqëruar nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ajo, përveç Haradinajt, ka takuar edhe presidentin Hashim Thaçi; kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli dhe përfaqësuesit politikë të opozitës. Schmid ka u ka bërë thirrje përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës që t'i kryejnë sa më parë detyrimet që kanë marrë përsipër, përfshirë edhe reformat e nevojshme, në mënyrë që vendi të ecë drejt Bashkimit Evropian. "Kosova është Evropë dhe e ardhmja e Kosovës është me Bashkimin Evropian", ka deklaruar ajo. "Mesazhi im i sotëm si për përfaqësuesit në qeveri, ashtu edhe ata në opozitë është që të shfrytëzoni momentin. Mendoni në mënyrë strategjike dhe shfrytëzoni mundësitë që t'i bëni përparimet e duhura që të afroheni me BE-në sa më shpejt që është e mundur", tha Schmid. Ajo rikujtoi fjalët e komisionerit Jean-Claude Juncker se dyert e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura kurdo që këto shtete t'i plotësojnë kushtet për anëtarësim. Schmid u ndal edhe te procesi i liberalizimit të vizave, si një prej çështjeve që vazhdon të mbetet e pazgjidhur në raportet e Kosovës me vendet e Bashkimit Evropian. Ajo tha se Kosova duhet t'i plotësojë kriteret, duke ratifikuar demarkacionin me Malin e Zi. "Ne gjithashtu e dimë se sa i rëndësishëm është liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Prandaj është esenciale që autoritetet të përmbushin kushtet e mbetura për liberalizimin e vizave dhe në veçanti në ecjen përpara me marrëveshjen për demarkacion të kufirit me Malin e Zi, që është absolutisht çështje kryesore dhe po ashtu lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të vazhdojë", u shpreh Schmid. Ndërkaq, në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbinë, të lehtësuar nga BE-ja, ajo tha se të dyja vendet duhet të avancojnë për të mirën e stabilitetit në rajon. "Dialogu po jep rezultatet e veta dhe ashtu siç e kemi parë këtë javë, është zbatuar marrëveshja për drejtësinë dhe ky ishte një hap i rëndësishëm përpara. Më lejoni që t'ju konfirmoj se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Fererica Mogherini është plotësisht e përkushtuar për fazën e re të dialogut", tha Schmid. Ajo tha gjithashtu se edhe implementimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian ka një rëndësi të madhe dhe sipas saj, absolutisht është e nevojshme që të zbatohet. Implementimi i kësaj marrëveshjeje ka të bëjë me ndryshimet pozitive për të ardhmen e Kosovës. "Kjo marrëveshja ka të bëjë veç tjerash, me standardin e jetës, përmirësimin e jetës, çka nënkupton më shumë investime dhe më shumë vende pune", tha Schmid. Në anën tjetër, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se Kosova është e vendosur në zbatimin e detyrave që i janë caktuar. "Dinamika e Kosovës me BE-në po intensifikohet. Mendoj se edhe takimi i sotëm me zonjën Schmid, që është sekretare e Përgjithshme vërteton edhe rëndësinë e kësaj dinamike, por është edhe një shtyrje për një punë më intensive me zbatimin e agjendës evropiane për Kosovën, e cila fokusohet në reforma të përgjithshme, forcimin e rendit dhe ligjit, pra që ka në fokus luftën kundër korrupsionit dhe krimit në vend, e njëkohësisht reformën ekonomike që e kemi si detyrë të përbashkët të dakorduar", tha Haradinaj. Sekretarja e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Helga Schmid, është takuar me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi; kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, por edhe përfaqësuesit e partive politike opozitare të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje.



Sekretarja e Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Helga Schmid

**MARRËVESHJA**

"Dialogu po jep rezultatet e veta dhe ashtu siç e kemi parë, këtë javë është zbatuar marrëveshja për drejtësinë dhe ky ishte një hap i rëndësishëm përpara. Më lejoni që t'ju konfirmoj se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Fererica Mogherini është plotësisht e përkushtuar për fazën e re të dialogut", tha Schmid.



# Trafikonte heroinë dhe kokainë me vlerë 500 mijë euro, arrestohet shqiptari

**ITALI** - Mëngjesin e së mërkurrës, policët e Olbias në Sardenjë të Italisë kanë arrestuar Ramazan Malon, shqiptarin 52-vjeçar, banor në këtë qytezë për trafik droge. Tek autoritetet italiane u ngjallën dyshime, pasi ndaluan shqiptarin në një pikë kontrolli, i cili po kthehej në Sardenjë nga Korsika. Itinerari i çuditshëm që bëri Ramazan Malo për të shkuar në shtëpi dhe sigurisht nervozizmi që tregoi kur u ndalua nga policia, tërhoqi vëmendjen e karabinierëve, të cilët vendosën të thellonin kontrollin. Duke kërkuar në makinë, autoritetet italiane gjetën 1.5 kg heroinë të ndarë në tri pako dhe në kërkimin e mëvonshëm në shtëpinë e shqiptarit gjetën edhe 1.2 kg kokainë. Nëse droga do të shitej në treg, do të arrinte vlerën gjysmë milioni euro.

## SHKURT

### Vrau shqiptaren, dënohet me burg të përjetshëm autori

**ANGLI**- Një emigrant 28-vjeçar është dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata Blackfriars Crown në Britaninë e Madhe për vrasjen e një 32-vjeçareje me origjinë nga Shqipëria. Noor Mohammad qëlloi me thikë për vdekje 32-vjeçaren Romina Kalaci, e cila ishte punonjëse seksi në Britaninë e Madhe, pas largimit nga Italia. Kalaci u qëllua për vdekje në shtëpinë e klientit të saj, Mohammad në datën 29 maj. Policia e gjeti trupin e saj të pajetë në dhomë në Kilburn të Londrës, ndërsa autori u arrestua disa ditë më pas. Në Itali ajo punonte si kameriere.

### Asociacioni i Komunave, Lista Serbe "qahet" tek Hoyt Brian Yee

**KOSOVË**- Përfaqësuesit politikë të serbëve në Kosovë janë takuar sot me zëvendësndihmës sekretarin e SHBA-ve, Hoyt Brian Yee. Gjatë këtij takimi, serbët kanë shprehur shqetësimin se edhe pas 1650 ditëve të nënshkrimit të marrëveshjes në Bruksel për formimin e komunave me shumicë serbe, nuk janë marrë hapat e para konkrete në zbatimin e saj. Zëvendëskryeministri Dalibor Jevtiç, kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiç dhe deputeti i Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës, Igor Simiq kanë theksuar problemet që serbët përballen çdo ditë në Kosovë dhe ndikojnë në mbijetesën dhe zhvendosjen e tyre raporton "Novosti". "Formimi i komunave me shumicë serbe është një nevojë jetike dhe mund të zgjidhë shumë probleme në funksionimin e përditshëm dhe jetën e qytetarëve serbë, kjo nuk duhet të trajtohet si çështje politike, por jetësore", ka thënë Jevtiç.

## Dega Inxhinieri Pyjore vetëm 13 studentë, Arkitekturë Peizazhi 17 të tillë

# Shpallen fituesit e masterit në Universitetin Bujqësor të Tiranës

## *Ja emrat te Financa e Agrobiznesi*

Voltiza Duro

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka shpallur fituesit në ciklin e dytë të studimeve master shkencor dhe master profesional për vitin akademik 2017-2018. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën e studimit në master në të gjitha programet e studimit që ofron ky universitet. Plot 753 studentë do të bëhen pjesë në një prej degëve të Universitetit Bujqësor, respektivisht 500 në master profesional dhe 253 në master shkencor. Te ky i fundit, dega Financë Kontabilitet paraqet numrin më të madh të studentëve me 40 të tillë, më tej vijon programi Drejtim Agrobiznesi me 30 studentë fitues në ciklin e dytë të studimeve. Numri më i ulët i studentëve të regjistruar në master shkencor në UBT rezulton në programin Inxhinieri Pyjore me vetëm 13 studentë. Masteri profesional në këtë universitet ka pasur një interes më të lartë, ku në degën Financë-Kontabilitet janë shpallur fitues plot 150 studentë, për të vijuar më tej me programin Drejtim Agrobiznesi me 109 studentë fitues e Menaxhim Mjedisi me 60 të tillë. Ndërsa në degën Arkitekturë Peizazhi janë regjistruar vetëm 17 studentë, çka paraqet edhe numrin më të vogël të të interesuarve në ciklin e dytë të studimeve master profesional në UBT.

### UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES

### FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT TEKNOLOGJI TE AVANCUARA NE HORTIKULTURE

Nr. Emer Atesi Mbiemer
1 Izmir Idaim Ivani
2 Elton Islam Karaj
3 Malbona Martin Meshaj
4 Gerta Elenik Lolo
5 Denisa Xhavit Xherri, Maloku
6 Brigena Fadil Seci
7 Kiti Fitim Zema
8 Leonard Shaban Muça
9 Manol Pelush Isufaj
10 Evis Agim Dervishi
11 Lulzim Refat Joca
12 Entela Qemal Xhaferri
13 Armond Deli Metaliaj
14 Lufter Haxhi Kurti
15 Markel Petrit Yzo
16 Gramoz Zaim Hasa
17 Liserda Arjan Hoxha
18 Elda Xhavit Qarri
19 Arjeta Abdulla Neza
20 Alon Spahi Belaj
21 Alfred Osman Rrahmani
22 Armand Faik Lame
23 Xhulian Gramoz Haxhillari
24 Florjan Bashkim Lila

### FAKULTETI BUJQESISE DHE MJEDISIT

Nr. Emer Atesi Mbiemer
1 Abedin Riza Muçaj
2 Armand Besim Bastari
3 Anjeza Esat Xhixha
4 Oresti Bashkim Dërvishi
5 Nuela Fatos Lami
6 Erdis Mujo Alika
7 Migena Sul Bilali
8 Mark Zef Suli
9 Esmeralda Aleks Pergjegji
11 Adola Adem Laçi
12 Nexhat Reshat Nerguti
13 Rei Seit Meko
14 Arnold Shkelzen Gjonaj
15 Lejdi Maliq Allbani
17 Urim Myfit Myftaraj
18 Eluerta Besnik Gjeçi
19 Fjoralba Bedri Lama
20 Alfred Tahir Gega
21 Artan Gjovalin Pjetri
22 Ergis Bisar Hoxha
24 Ramazan Remzi Lika
25 Manush Sefullah Shehi
26 Gazmir Shkëlqim Kera
27 Hava Roland Kozma
28 Blerina Mara Mara
29 Edlira Ymer Tonuzi
30 Fatjon Ymer Elezi
31 Ervin Hysni Kacdedja
32 Ardit Qamila Kallari
33 Mevlan Petrit Muça
34 Skerdi Agim Qaseja
35 Mirela Rexhep Matoshi
36 Brisilda Nezir Daci
37 Juljan Zylif Avdiu
39 Mareldo Muharrem Xhixha
40 Ndue Fran Prenga
41 Emiljano Luan Gogo

### FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT LISTA E FITUESVE NE MASTER PROFESIONAL - ARKITEKTURE PEJZAZHI

Nr. Emer Atesi Mbiemer
1 Vjolka Ferdinand Berhami
2 Blerina Sadik Mehmetaj
3 Sidorela Thanas Bani
4 Fatjona Refik Topçiu
5 Lorena Xhevahir Allder-vishi
6 Sherinald Helidon Turku
7 Albion Pelivan Pirko
8 Ilaria Kujtim Shushku
9 Artjonild Lefter Gjata
10 Sabina Hysen Koni
11 Fatjon Servet Xhaferraj
12 Irisa Shyqyri Karaj
13 Floreta Nexhip Gjermiza
14 Albin Bujar Kelliçi
15 Irena Islam Kaso
16 Hejli Shaqir Pupuleku
17 Ignat Josif Basha

### FAKULTETI BUJQESISE DHE MJEDISIT

### DEPARTAMENTI AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Ylli Bajram Metallari
2 Dezantina Faik Lala
3 Suela Ylli Bejtja
4 Dorjana Besim Mehidri
5 Greta Behar Sulaj
6 Erilda Agim Troci
7 Elda Kimet Stojku
8 Xhuljana Ismail Hoti
9 Artinisa Sokol Hilaj
10 Anxhela Esat Kallçishta
11 Elisa Shkëlqim Hoti
12 Enkeleda Ismet Brih-mani
13 Sonja Abas Shallas
14 Lueda Edmond Zhllima
15 Ertjola Behar Alollari
16 Anxhela Agron Kola
17 Erismonda Zek Ngjeçi
18 Elsin Irfan Dokaj
19 Nisibe Zigur Çulli
20 Elizada Zaim Tollja
21 Lule Elmaz Hasalamaj
22 Sidorela Xhevdet Totraku
23 Alush Shaqir Lazri
24 Ana Sali Ceni
25 Tea Luan Qerimi
26 Malvina Ferim Hasanaj
27 Iris Qemal Dauti
28 Vilma Muharem Zaçe
29 Jasmina Kujtim Cakoni
30 Erti Aleksanër Çalaku
31 Arnold Shkelzen Gjonaj
32 Elina Fadil Rrushi
33 Meldi Vebi Leka
34 Emiljano Leonard Karriqi
35 Migena Besim Bodlli
36 Benareta Halil Kurti
37 Samuel Irfan Hoxha
38 Urim Myfit Myftaraj
39 Jonilda Selim Memia
40 Enea Nderim Zani
41 Migena Petrit Kurti
42 Marinel Agur Bardhaj
43 Xhulio Stojan Angjellari
44 Eni Lulëzim Rustemi
45 Thanas Pandeli Gurma
46 Arshin Neim Lemnusha
47 Kevin Arben Gjika
48 Enkeleda Alush Sefa
49 Ramazan Remzi Lika
50 Violanda Astrit Sinanrapaj
51 Raela Destan Leka
52 Besard Ali Zeli
53 Guido Luan Veizi
54 Ylli Fatmir Lusha
55 Brikena Perparim Muçaj
56 Ornel Bashkim Caushaj
57 Alban Kujtim Allushi
58 Lisandri Gëzim Topalli
59 Alban Ndok Lleshaj
60 Brunilda Flamur Prenga

### FAKULTETI I EKONOMISE DHE AGROBIZNESIT

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Lorela Arqile Marra
2 Mirka Fitim Isufaj
3 Donald Idriz Basha
4 Bora Agron Babameto
5 Belina Lavdrim Beqiri
6 Anxhela Refik Allgjata
7 Elkitona Shkëlqim Kadiu
8 Eriselda Arben Hoxhalli
9 Fjoralba Dashamir Doku
10 Elisabeta Luëlzim Hoti
11 Andi Qani Bajrami
12 Spiro Andon Tomani
13 Orjona Rahim Ymeri
14 Fabiana Resmi Kuçi
15 Brisilda Ali Gjoka
16 Alfons Ndoc Vukaj
17 Julian Ferdinand Kola
18 Xhesika Ramiz Kalemaj
19 Marsela Skënder Osmrija
20 Daniela Hasan Jaho
21 Xhesiana Nazmi Braho
22 Oralda Vladimir Bushpepa
23 Marinela Gjin Rica
24 Aurora Robert Fejzaj
25 Anile Petrit Gashi
26 Kristina Hilë Preçi
27 Ardita Nebi Berisha
28 Tanja Artan Ali
29 Ilda Haxhi Tufa
30 Katerina Nesti Çerma
31 Besjana Bajram Danaj
32 Gentiana Faik Selimaj
33 Mariglen Hajdar Cakon
34 Marsilda Sabahudin Goxha
35 Altina Ilija Vllaka
36 Elsa Tahir Peposhi
37 Xhensila Xhavit Çenja
38 Denada Përparim Lleshi
39 Entela Vesel Rusi
40 Jonida Bejdash Bega

41 Marsida Sinan Bubku
42 Julios Fadil Çela
43 Elez Mehdi Bici
44 Dritan Rahmi Thomaraj
45 Elina Kastriot Bala
46 Matilda Limoz Selamaj
47 Juana Xhevahir Perhati
48 Ilda Islam Dishi
49 Erisa Fatmir Brahaj
50 Silvana Prend Palushi
51 Jonida Ismet Shahu
52 Esmeralda Alush Nxheçi
53 Greta Hekuran Myftaraj
54 Mite Adem Shahini
55 Erxhildo Dukator Telallari
56 Etarb Arben Maloku
57 Erjon Hajdar Bali
58 Suada Lutfi Isufi
59 Gertjan Sherif Kopani
60 Suela Zazan Duro
61 Iva Gëzim Dhima
62 Kejsi Arjan Gaba
63 Fabio Fatmir Ibrahimi
64 Marius Naim Sinani
65 Manuela Ramazan Gjoka
66 Arjeta Isa Lajthiza
67 Rezarta Kamber Nezha
68 Anxhela Hysen Bekteshi
69 Malvina Besim Carungu
70 Sara Agron Xhafa
71 Anxhela Sotir Kreka
72 Erjona Tomor Shehi
73 Klevin Petrit Binaj
74 Megi Edmond Bektashi
75 Ergesa Ëngjëllush Rustem
76 Aishe Zabit Lila
77 Fabjola Arben Hoxha
78 Lorena Përparim Tota
79 Indrit Prend Hidri
80 Deivis Andrea Ndoja
81 Ornela Dashamir Datja
82 Valbona Liman Balla
83 Entela Mufit Tafaj
84 Denada Idriz Shehi
85 Gledison Ferit Troçi
86 Dael Dashnor Dosti
87 Kozeta Fatmir Çimo
88 Gentjana Bardhok Pjetri
89 Ilda Gëzim Muda
90 Jurgen Hysen Dervishi
91 Oneda Enver Halipaj
92 Ambra Ilia Çaushaj
93 Erjola Ismail Muço
94 Iranda Ismet Tota
95 Migena Behar Ajazi
96 Aurora Zenel Sata
97 Ermelinda Agron Metohu
98 Blerina Refik Losha
99 Marvi Lirim Abazi
100 Erion Muj Papa
101 Kostandina Vladimir Xamo
102 Enxhi Ramiz Aliaj
103 Klajd Hasan Ademi
104 Fitnete Ferit Duraaku
105 Joreza Agim Meço
106 Xheni Luan Vinjolli
107 Pellumbesha Ndok Gjoni
108 Oneda Lulzim Vrana
109 Ariston Hajdin Sula
110 Lorenc Hysen Hasa
111 Silvio Artan Muça
112 Tea Agim Vasiu
113 Ledio Nazmi Juniku
114 Endi Orhan Koçi
115 Amela Shpëtim Belalla
116 Anxhela Gjin Toma
117 Aida Shaban Çela
118 Alma Rezvan Sharka
119 Malvina Arjan Celami
120 Besjana Ylli Albrahim
121 Pamela Resmi Bilbili
122 Kledja Osman Peca
123 Hygerta Kujtim Shehi
124 Megi Haxhi Tola
125 Sidorela Astrit Mustafaraj
126 Armela Viktor Perndreca
127 Adela Bujar Skora
128 Vilma Shpëtim Taku
129 Aferdita Ylber Sinaj
130 Florjana Muharrem Dervishi
131 Gentian Mersin Toçka
132 Maksi Arjan Kaçaku
133 Romino Fejzi Hajdari
134 Nexhjana Bardhul Serani
135 Julinda Adem Leka
136 Ejana Spartak Hatipi
137 Migena Mustafa Myrta
138 Xhensila Rexhep Koçi
139 Ariela Sokol Çikaj
140 Arvenola Et'hem Shukulli
141 Erjalda Bujar Pajaziti
142 Fatjon Hysen Metko
143 Megi Arjan Kokona
144 Fabian Atli Lazri
145 Enisa Ismail Duka
146 Florjana Kamber Jeminaj
147 Anxhela Ardian Loshja
148 Borana Gani Sina
149 Erina Safet Rexhepi
150 Tefik Agim Qerimi

## DEPARTAMENTI EKON. &POL. ZHVILL. RURAL

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Ari Kamber Hysollari
2 Elhame Arsim Istrefi
3 Silvana Han Troci
4 Manuela Ramazan Gjoka
5 Monika Jorgji Çepele
6 Ferim Kasem Hasanaj
7 Gentiana Shahin Nela
8 Hektor Shemsi Daci
9 Romarjo Alekdsander Hoxhaj
10 Indrit Prend Hidri
11 Ketjona Flamur Xheta
12 Suela Zazan Duro
13 Gezim Zymer Mulaj
14 Elez Mehdi Bici
15 Alada Dashamir Poti
16 Brunilda Halim Pergjegja
17 Ilda Gezim Muda
18 Anisa Sokol Murataj
19 Enesa Enver Mehmeti
20 Edlir Abdulla Vathi
21 Adiola Ferit Canameti
22 Melisa Arben Murati
23 Anisa Dilaver Kaperi
24 Megi Besnik Merja
25 Marvi Lirim Abazi
26 Armandao Dervish Agalliu
27 Enxhi Ramiz Aliaj
28 Ajet Kala
29 Ardit Misir Pole
30 Gentjana Pjeter Pjetri
31 Hygerta Kujtim Shehu
32 Nuri Rifan Lumi
33 Marinela Llesh Metaj
34 Arjola Tonin Doci
35 Mario Hysen Hajdari
36 Enxhi Muhamet Mali
37 Orijo;Alslam Karaj
38 Amijeta Xhevahir Dumani
39 Xheni Skender Keqi
40 Megi Lutfi Hata
41 Oligerta Ferhat Shkurta
42 Ilda Ilirian Topçi
43 Elton Sherif Shehu
44 Iris Bardhyl Shkupi
45 Enisejda Afrim Azuni
46 Renato Fadil Haka
47 Frida Shpetim Baruti
48 Rozeta Ismail Bnuna
49 Shpresa Azgan Selimaj
50 Monika Ismail Murataj
51 Alma Rezvan Sharka
52 Gertjana Nuredin Duro
53 Amarilda Lefter Palluci
54 Klisina Muahrrem Demiri
55 Armela Arben Xhemali
56 Klaudio Abaz Zaimi
57 Brunilda Sheriv Lumani
58 Aldo Fatmir Doda
59 Ildi Iljaz Shehi
60 Juljan Kadri Bulica
61 Eni Ramazn Cecja
62 Eduart Fatmir Rama
63 Lurenc Myftar Koromani
64 Gersi Fatmir Dafku
65 Leonard Imer Babasi
66 Majrus Daut Sharka
67 Ilira Selahedin Bilbili
68 Krisilda Ali Hoxha
69 Elton Agim Xhelili

## DEPARTAMENTI DREJTIM AGROBIZNESI

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Gentjan Karafil Rata
2 Edlira Fredi Tota
3 Donald Idriz Basha
4 Lartësim Asllan Dervishi
5 Andi Xhek Xheka
6 Dritan Xhemal Gjoni
7 Dario Artan Metaj
8 Enida Nuri Hoxha
9 Ilir Azgan Tahiraj
10 Rexhina Agim Bilali
11 Iva Gëzim Dhima
12 Olsi Munir Hoxha
13 Nertila Myftar Koroni
14 Anxhela Sotir Kreka
15 Migena Bujar Poti
16 Eraldo Agur Kalemaj
17 Rigersa Artur Ramaq
18 Ornela Dashamir Datja
19 Fatos Izet Kola
20 Kejsi Arjan Gaba
21 Migena Pllumb Delia
22 Danjela Ludovik Rajta
23 Lorena Përparim Tota
24 Ledi Martin Nikolli
25 Enea Lavdërim Keco
26 Ariston Ajdin Sula
27 Mirela Ferdinand Daulle
28 Eneida Shpëtim Furriku
29 Irena Hajdar Mërzhegu
30 Gjulsime Salih Alijaj
31 Besjan Man Zeneli
32 Erisa Fatmir Brahja
33 Marvi Lirim Abazi
34 Fationa Sami Berdellima
35 Vilma Shpëtim Tabaku
36 Adriana Adriatik Çekiçi
37 Gentian Mersin Toçka
38 Xheni Alfred Cermurati
39 Karafile Shaban Gjeli (Hasanaj)
40 Ori Riza Isakaj
41 Eni Albert Kuzari
42 Endi Orhan Koçi
43 Anxhela Kastriot Shehu
44 Ariela Sokol Çikaj
45 Orsjola Liman Morina
46 Xhulio Idajet Olldashi
47 Zina Ludovik Fetaj
48 Fisnik Muharrem Kuçaj
49 Oneda Enver Halipaj
50 Enxhi Agim Hysa
51 Fari Seit Shuli
52 Fabiola Xhevdet Çaushi
53 Brunilda Naim Duka
54 Artjola Zyhdi Çuni
55 Megi Bajram Muça
56 Artan Astrit Ahmeti
57 Ernest Dukat Tuzi
58 Françeska Genc Potoku
59 Sara Muharrem Bakalli
60 Erion Gjovalin Tuci
61 Romino Fejzi Hajdari
62 Selim Abas Allushi
63 Tereza Mikel Gjonaj
64 Erles Myrtezan Qypi
65 Marine Misim Vladi
66 Shkëlqime Ramadan Bodi
67 Xhesika Edmond Çaushaj
68 Julian Petrit Kelo
69 Xhorxh Daut Laçka
70 Xhovana Astrit Stefi
71 Myrteza Selman Qordja
72 Regers Vehbi Vuka
73 Sidorela Xhafer Koxho
74 Kristo Pavllo Vurmo
75 Brikita Lulzim Vrana
76 Arvenola Et'hem Shukulli
77 Adela Naim Qorri
78 Daniel Llambi Drushku
79 Erisa Astrit Sala
80 Françeska Ilir Surreli
81 Florina Mus Muçmata
82 Arsina Zaim Xhediku
83 Megi Arjan Kokona
84 Sidorela Astrit Mustafaraj
85 Xhoi Gjovalin Pjetri
86 Jurgena Besnik Zhurda
87 Kristi Stefan Marku
88 Enxhi Behar Pipero
89 Eftimi Hasan Spasiu
90 Gazmir Shyqiri Koni
91 Alma Avni Memia
92 Adriana Halim Selivrada
93 Xhenifera Ludovik Pemati
94 Aurela Ibrahim Hajdarmataj
95 Erjon Xhemal Metaj
96 Jonien Paulin Jaku
97 Marjan Pashk Gjoka
98 Krisli Asllan Gura
99 Adelina Sefedin Abazi
100 Marjus Daut Sharka
101 Klodian Pashku Deda
102 Blerim Hiqmet Zeneli
103 Kaludio Abas Zaimi
104 Adi Petrit Kamami
105 Adelajdi Ibrahim Xheka
106 Doris Bahar Kakeli
107 Pranvera Hysen Kurti
108 Renato Fitim Zdrava
109 Blerina Albertt Xhaxhiu

## DEPARTAMENTI SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BIMORE

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Arsida Sdhimiter Kola
2 Habibe Erzen Spahiu
3 Klaudja Flamur Kamani
4 Orges Hysni Shuka
5 Elenica Vilson Bella
6 Eduart Ritfan Mirashi
7 Ervis Mehmet Gjoni
8 Esmeralda Aleks Pergjegji

9 Migena Sul Bilali
10 Elda Artur Cocka
11 Xhoana Flamur Malja
12 Anxhela Sotiraq Qendro
13 Sherih Xhezmi Hima
14 Ramazan Remzi Lika
15 Leonard Islam Lika
16 Ardit Qamil Kallari
17 Platin Hasan Hamati

**DEPARTAMENTI I MBROJTJES BIMËVE**

Nr Emri Atesia Mbiemri
1 Lorena Astrit Zote
2 Xhustina Vath Mersini
3 Xhenisa Jani Ylliu
4 Ardita Alush Elezaj
5 Meti Kodhel Ramo
6 Alban Gezim Muhametaj
7 Anxhela Besnik Dellani
8 Andrea Jorgo Melani
9 Anxhela Bejkush Mehmeti
10 Tea Minush Troka
11 Juela Krenar Jaupllari
12 Vezire Vrenos Buzali
13 Henrik Xhevair Kasa
14 Florald Mexhit Sina
15 Sajmir Ragip Elezaj
16 Elidora Agim Cuku
17 Ardit Mikail Mone
18 Erando Zagoll Troka
19 Andi Arben Sollaku
20 Hyrgeta Xhevat Gërmizi

**FAKULTETI I SHKENCAVE PYJORE**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Kysmet Bislim Saraqini
2 Renaldo Niko Shahini
3 Rodolf Sokol Peci
4 Fatos Rexhep Lleshi
5 Ildo Petraq Trifoni
6 Likian Dervish Isa
7 Muharrem Rait Skera
8 Antonio Kostika Kapshtica
9 Ernest Pal Ramaj
10 Irvi Luigj Dedgjonaj
11 Euxhina Myzafer Mara
12 Feruze Dilaver Zyko
13 Leonard Ndue Lleshi

**DEPARTAMENTI EKON. &POL. ZHVILL. RURAL**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Klea Eqerem Halili
2 Emirjana Halim Sula
3 Shpetim Fari Zaimaj
4 Majlinda Zabit Bara
5 Iva Ferdinandc Çarçiu
6 Habibe Bedri Duda
7 Rafaela Azem Ibra
8 Irjada Elmi Meta
9 Klodjan Hamez Xhafa
10 Sabah Nexhati Bejtaga
11 Elsa Thir Peposhi
12 Silvana Han Troci
13 Gentiana Shahin Nela
14 Lorena Perpariim Tota
15 Hektor Shemsi Daci
16 Romario Aleksander Hoxhaj
17 Ketjona Flamur Xheta
18 Edison Pjeter Dedndreja
19 Enesa Enver Mehmeti
20 Adiola Ferit Canameti
21 Ardit Misir Pole
22 Marinela Gjon Hodaj

**INXHINIERI AGRARE DREJTIMI ZOOTEKNI**

Nr Emer Atesi Mbiemer
1 Asllan Bledar Tabaku
2 Ketjona Xhemal Peposhi
3 Fatjona Flamur Bracja
4 Evdar Engjellush Spaho
5 Alisa Ilir Subashi
6 Bledar Hajri Abdishahi
7 Vesart Arben Guri
8 Montea Edmond Shehu
9 Xhesika Arian Abazi
10 Desara Ramazan Cela
11 Desantila Rexh Dautaj
12 Mario Kujtim Shalari
13 Florend Saimir Sinka
14 Egest Faik Baruti
15 Suela Hamit Haklaj

**DEPARTAMENTI I MBROJTJES BIMËVE**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Keidi Sherif Kuci
2 Xhoana Shaqir Qordja
3 Redion Jak Uka
4 Myslym Ylli Vecani
5 Nexhat Nexhip Kaculi
6 Anisa Pjeter Bibaj
7 Fatime Mahmut Brari
8 Viola Bujar Brari
9 Entela Shefqet Picari(Mema)
10 Olsa Ali Dodgjini
11 Gildar Bujar Shorri
12 Erand Kostandin Gjordeni
13 Valentina Sulejman Basha
14 Fjoralba Halim Peci
15 Emirjan Uc Hasmujaj
16 Gentian Ndoc Pjetri
17 Elderim Fiqeri Cela
18 Agim Petref Gjonzenelaj
19 Klaudia Sadik Harka
20 Rizvalt Hyqmet Basha
21 Jonida Syle Camaj
22 Paolo Qemal Cala
23 Shkelzen Zeim Muça
24 Rexhino Sadik Harizi
25 Erinda Idajet Hysa
26 Miglen Halit Luzi
27 Esmir Zini Çapoku
28 Emiljano Haredin Toshkezi
29 Klaudio Shezaim Gjolleshi
30 Mirjan Xhevair Lushnjaku

**FAKULTETI BUJQESISE DHE MJEDISIT DEPARTAMENTI SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BIMORE**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Jonida Bajram Goma
2 Vitera Jorgo Lukra
3 Eglantina Hyqmet Skenderi
4 Kelvin Dhimitraq Tomcja
5 Eneda Enver Dishani
6 Haxhire Jemin Allaraj
7 Anxhela Dule Dulaj
8 Adriana Pellumb Beqiri
9 Nertila Tonin Vulaj
10 Anxhela Lulzim Lala
11 Erxhin Enver Mukja
12 Joana Luigj Gjoka
13 Emiljano Dashnor Zeqillari
14 Monika Jani Ylli
15 Jetmira Xhem Muaratj
16 Migena Rufit Rexhepi
17 Xhuljo Gezim Mema
18 Besnik Qemal Goma
19 Rei Seit Meko
20 Perviz Nexhmi Neli

**DEPARTAMENTI AKUAKULTURE DHE PESHKIM**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Kristian Prend Beqiri
2 Henri Arjan Kostreni
3 Alban Eqerem Ibrahimaj
4 Paola Qamil Lazaj
5 Anxhela Xhafer Gerdeci
6 Aleksandro Janaq Konomi
7 Enerisa Ruzhdi Zenelaj
8 Andi Gojar Dishnica
9 Kristjan Simon Luli
10 Xhelil Qani Xhelili
11 Hasan Hysen Laci
12 Armando Viktor Lleshaj
13 Orsijola Beqir Pavliqoti
14 Jonida Sleman Hasi
15 Aida Fatmir Hajdari
16 Renato Fitim Zdrava
17 Entan Enver Kadilliu

**DEPARTAMENTI AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE**

Nr. Emri Atesia Mbiemriri
1 Xhuljo Kristaq Sema
2 Anxhela Sulejman Ismaili
3 Afërdita Kimet Ndojaj
4 Enxhina Gëzim Malaj
5 Kristiana Sokol Çala
6 Olbesa Avni Kaçi
7 Anila Kujtim Allushi
8 Alban Bedri Preçi
9 Reina Fatri Mezini
10 Riselda Xhavit Batalli
11 Adela Hazbedin Topi
12 Erjona Shefqet Demiri
13 Leme Enver Hoxha
14 Dorina Dashamir Torba
15 Xheni Dritan Sema
16 Bjona Zef Rushaj
17 Shkëlqim Sefer Ahmetaj
18 Anisa Behar Pashaj
19 Ersenida Hekuran Muçaj
20 Enxhi Isuf Albrahimi
21 Xheni Qemal Canameti
22 Orlando Kujtim Bakalli
23 Enxhi Demokrat Xhamallati
24 Olsi Ali Sheta
25 Erisa Fatos Hoxhaj
26 Adola Adem Laçi
27 Laura Viron Ferati
28 Riena Ferik Mema
29 Alket Arif Mata
30 Fjoralba Bedri Lama

**DEPARTAMENTI DREJTIM AGROBIZNESI**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Oltion Dervishi
2 Ami Vetmi Keta
3 Adela Fatmir Leka
4 Adela Fatmir Demçja
5 Enea Sofokli Qose
6 Fabiola Agim Halilaj
7 Kristina Vasil Prishka
8 Gloria Luan Abas
9 Ergys Ali Mema
10 Xhenifer Fatmir Pira
11 Vilma Roland Bejko
12 Suela Kujtim Kurti
13 Kaudia Besnik Dunga
14 Ina Xhafer Brahja
15 Sara Luan Hoxhiq
16 Xhensila Hysen Gjoka
17 Kamela Eduard Ismolli
18 Lediana Samedin Hyka
19 Enida Nuri Hoxha
20 Blerta Bashkim Kastrati
21 Erxhildo Dukator Telallari
22 Suada Lutfi Isuf
23 Olsi Munir Hoxha
24 Kejsi Arjan Gaba
25 Endrit Bujar Çeku
26 Sonila Arben Saliasi
27 Migena Bujar Poti
28 Rigersa Artur Rama
29 Erild Arben Eshja
30 Dallandyshe Isuf Elezi

**INXHINIERI AGRARE DREJTIMI HORTIKULTURE**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Shqipe Emin Bytyqi
2 Ornela Ismet Kertolli
3 Ticiana Armando Asllani
4 Stela Petrit Leci
5 Besjana Shkelqim Bruci
6 Elda Enver Shpata
7 Suada Bedri Hasa
8 Kristina Leandro Seva
9 Eva Muharrem Guxha
10 Arjola Gjin Kura
11 Davina Gezim Gjoka
12 Aida Ali Pepmarku
13 Gjuljana Gjin Dedaj
14 Fatbardha Avni Neza

**DEPARTAMENTI FINANCE-KONTABILITET**

Nr. Emri Atesia Mbiemri
1 Morava Nexhat Hoxha
2 Bajame Edmon Vosela
3 Ilda Laim Loka
4 Kristina Lulëzim Sila
5 Luiza Rakip Kurumi
6 Sidorela Sinan Kurdina (Marku)
7 Dorina Artan Nona
8 Bruna Duka Tuzi
9 Denisa Halit Baba
10 Anxhela Besnik Huqi
11 Sidorela Krenar Dervishi
12 Kristina Vasil Prishka
13 Migena Bujar Qerimi
14 Marjeta Bujar Duraku
15 Ordiola Viktor Saliasi
16 Klajd Eqerem Ismailaj
17 Irina Vasil Marku
18 Edona Hamëz Qerimi
19 Luan Alush Korreshi
20 Elisabeta Vullnet Tota
21 Behar Qani Derti
22 Elkitona Shkëlqim Kadiu
23 Emirjana Halim Sula
24 Fjorela Maksim Bregu
25 Elisabeta Lulëzim Hoti
26 Spiro Andon Tomani
27 Ornela Gentjan Guda
28 Andi Qani Bajrami
29 Orjona Rahim Ymeri
30 Suzana Seladin Imaku
31 Ambra Taip Halili
32 Alfons Ndoc Vukaj
33 Julian Ferdinand Kola
34 Xhesika Ramiz Kalemaj
35 Xhenifer Fatmir Pira
36 Marsela Skënder Osmrija
37 Blerim Artur Vezi
38 Daniela Hasan Jaho
39 Ilda Kanto Bici
40 Firgela Alush Beqari

Opinioni i Ditës

# A e njeh kryeministri rregullën që shkeli me gazetarët?

Julian Zyla

*(vijon nga faqja 1)*

...parlamentit?" Me të kishim punuar për fushatën e partisë së tij në zgjedhjet e fundit dhe si këshilltar komunikimi i kisha dhënë një nga porositë elementare: Asnjëherë nuk mund të thuhet asgjë kundër gazetarëve. Mesazhi vërtetonte që ai e mbante mend mirë këtë rregull. Po Kryeministri a e njeh rregullën e komunikimit politik që shkeli? Nëse e njeh, vërtetohet hipoteza që ishte një veprim për të tërhequr vëmendjen nga diçka më institucionale sesa përdorimi i fjalës "imunitet" nga gazetarët. Nëse nuk e njeh rregullën e respektimit pa kushte të figurës së gazetarëve, kemi një dështim në komunikim politik.

Në "ABC"-në e gjërave për t'u shmangur gjatë komunikimit politik, përplasja me gazetarët është B-ja. Më herët, z. Rama kishte shkelur edhe A-në. Gjatë një intervistë në Top Story në lidhje direkte me studion nga apartamenti i tij në Tiranë, Sokol Balla e pyeti se pse mendonte se njerëzit kishin përshtypjen se ai jetonte në luks, kur apartamenti i tij dukej mjaft normal. "Njerëzit nuk kanë me çfarë të merren. Njerëzve u pëlqejnë shpifjet…", ishin disa nga përgjigjet, që mund të kenë qenë për një grup të caktuar, por që nuk u përcaktua. Rregulla A: asnjëherë nuk mund të thuhet asgjë kundër njerëzve. (Për kuriozët e C-së: mos përsërit asnjëherë tekstualisht apo pjesërisht kritikat ndaj teje.)

Ata që mendojnë se ishte diçka e mirëmenduar lëvizja e kryeministrit përballë gazetarëve përmendin shprehjen e tij: Kam dalë enkas për t'u marrë me ju. Një gazetare tha, gjithashtu, se kryeministri nuk u dha as kohë të bënin pyetje. Por këto argumente nuk përjashtojnë mundësinë që ai të ketë qenë vërtet i pakënaqur nga debati mediatik i ditëve të fundit. Nëse kjo është e vërtetë, a mund të jetë i legjitimuar të shprehë "opinionin" e tij kundër gazetarëve? Trump mendon se po.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara Donald Trump është i famshëm për kritikat e tij ndaj mediave amerikane. Ai fitoi zgjedhjet, pavarësisht, ose i ndihmuar, nga debati me mediat. A ka vendosur kryeministri të ndjekë të njëjtën strategji? A do të ishte kjo një ide e mirë?

Trump vendosi që strategjia e tij do të ishte të zgjidhej me entuziazmin e mbështetësve të tij. Mediat arriti t'i shfaqte si pjesë e grupit të kundërshtarëve politikë. Por a është kjo e mundur në Shqipëri? As kryeministri Rama nuk beson se gazetarët janë palë, por i akuzoi për paaftësi profesionale. Atëherë, çfarë mund të arrihet nga një strategji e tillë, që nuk mund të imitojë plotësisht situatën e Donald Trump?



Z. Rama nuk u tërhoq nga komentet e tij, por tha se nuk kishte ofenduar kënd duke dhënë argumente, sipas tij, objektiviteti. Gazetarët ndihen të ofenduar. Pra, çfarë u arrit politikisht? Përveç tërheqjes së vëmendjes nga çështja Tahiri për pak orë, vetëm dëmtim imazhi. Donald Trump u zgjodh President, por nuk është nga më popullorët e historisë amerikane. Nëse Hillary Clinton arrinte të ishte pak më krijuese dhe frymëzuese, Trump do të kishte paguar kosto, të cilat nuk përjashtohen për zgjedhjet e ardhshme. Kështu, Basha ka tani mundësinë të hyjë në lojë si politikani i vetëm modern në Shqipëri. Udhëheqësi që respekton pa kushte pushtetin e katërt. Njeriu që mund të thotë: Më bëni sa pyetje të doni. Më pyesni ashtu si i mendoni gjërat. Unë do të jap përgjigjet e mia pa ju sulmuar.

Shumica nga ne nuk mund ta dijë nëse veprimi i z. Rama ishte i përgatitur apo i sinqertë. Nuk mund të dimë nëse ai e njihte rregullën që po shkelte. Por ajo që mund të shohim është se reagimi që pasoi ishte me kosto, për imazhin e tij. Gazetarët janë krenarë, si profesionistët e shumë fushave të tjera. Megjithëse nuk kanë synim që politikanëve t'u pëlqejnë pyetjet (shpesh, ky do të ishte dështim për ta), ata pretendojnë respektin e të intervistuarve. Shumë politikanë e kanë të qartë këtë dhe e dinë që pyetjet e gazetarëve nuk merren si prova kundër tyre, madje në shumicën e rasteve, ato nuk dëgjohen ose nuk transmetohen. Pra, ata mund të përgjigjen si të duan. Mirë do ishte, për ta, të përgjigjen duke treguar respekt dhe pozitivitet.

"E ndoqe intervistën e Ramës sot jashtë parlamentit?" "Po, por e hoqa, nuk po e shihja dot." Që te fjalët e para, kuptova gabimin që po bënte kryeministri. Apo nuk ishte gabim?

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump është i famshëm për kritikat e tij ndaj mediave amerikane. Ai fitoi zgjedhjet, pavarësisht, ose i ndihmuar nga debati me mediat. A ka vendosur kryeministri të ndjekë të njëjtën strategji? A do të ishte kjo një ide e mirë?

Shumica nga ne nuk mund ta dijë nëse veprimi i z. Rama ishte i përgatitur apo i sinqertë. Nuk mund të dimë nëse ai e njihte rregullën që po shkelte. Por ajo që mund të shohim është se reagimi që pasoi ishte me kosto për imazhin e tij. Gazetarët janë krenarë, si profesionistët e shumë fushave të tjera. Megjithëse nuk kanë synim që politikanëve t'u pëlqejnë pyetjet.

## HOROSKOPI

### DASHI
Ndryshime të shpejta dhe pozitive, falë bashkëveprimit Diellit me Hënën që ju favorizojnë. Në vazhdën e vendimeve të marra, populllariteti juaj do të pësojë një rritje! Pak krijimtari dhe fantazi në profesion do t'ju sjellë vlerësimin e një eprori.

### DEMI
Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngelni mbrapa. Gjë që nuk është kushedi se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.

### BINJAKET
Planetët do të bëjnë që sot të ndiheni më materialistë se zakonisht. Por fatmirësisht pozicionimi i Uranit do t'ju ndihmojë që të çlironi fantazinë. Ndoshta zgjedhja që do të bëni nuk është ajo që do të pritej nga ju, po përdorni imagjinatën.

### GAFORJA
Një ditë pa shumë bujë. Nëse mendoni se meritoni më shumë, nuk keni bërë llogaritë me ata me të cilët duhet të ndani meritat. Në fund do të dini si ta menaxhoni situatën, pasi nuk doni që të dilni keq.

### LUANI
Shfrytëzoni favorizimin që planetët kanë për t'ju zmadhuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët tuaja. Nganjëherë nuk duhet të lodheni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

### VIRGJERESHA
Keni të bëni me çështje të brendshme dhe familjare të pazgjidhura, dhe mund ta shfaqni më shumë sesa duhet nervozizmin. Përpiquni ndërkaq të jeni i mirëkuptueshëm. Mund të gjeni gjithmonë një pikë të përbashkët dhe të arrini kështu në një kompromis me të gjithë.

### PESHORJA
Sot do të vini në jetë ide nismëtare. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë! .

### AKREPI
Ata që varen nga ju nuk bëjnë punën e tyre ashtu siç prisni, qortojini sigurisht, por pa e bërë të madhe. Nuk keni arsye perse ta bëni. Më mirë thojini gjërat siç janë, pa shumë lojë fjalësh, në mënyrë të qartë, të drejtpërdrejtë dhe të saktë.

### SHIGJETARI
Kujdes nga kokëfortësia, sepse mund të sjellë gjëra të pakëndshme. Më mirë të udhëhiqeni nga diku që ka më shumë përvojë se ju. Përvoja ju mëson, por nëse nuk jeni të sigurt për diçka njëqind përqind, nuk duhet as ta provoni.

### BRICJAPI
Nëse në të kaluarën keni marrë një ndihmë të papritur, tani është koha ta ktheni favorin pa u tërhequr mbrapsht. Në fund edhe ju do të shpërbleheni. E rëndësishme është t'ia nisni mbarë, nganjëherë gatishmëria vlen, në disa raste, më shumë se çdo gjë tjetër.

### UJORI
Nëse po shqyrtoni mundësinë për një udhëtim, për argëtim apo për punë, mos u ktheni mbrapa. Parashikohen përvoja shumë interesante në vijim! Mund të pasuroni bagazhin tuaj kulturor me njohje dhe njohuri të reja. Me të vërtetë shumë mirë.

### PESHQIT
Mos u hidhni shumë përpjetë, nëse nuk doni të rrezikoni të rrëzoheni! Duhet të qëndroni me këmbë në tokë dhe të mos përfshiheni nga aventura tepër të rrezikshme. Mendoni për pasojat e veprimeve që kryeni, do të shmangnit rrezikun për ta pësuar.

Opinioni i Ditës

# Pse ripajtimi gjermano-polak është ndër më unikët

Rigels Lenja

(vijon nga faqja 1)

... gjermano-polake. Krzyzowa nuk ishte jo një përzgjedhje rastësore apo teknike. Krzyzowa gjatë luftës së Dytë Botërore ishte ndër qytetet e para ku u krijua një grup rezistence për të përmbysur Hitlerin, i njohur si Rrethi i Krzyzowas. Shpeshherë thuhet se konflikti mes Gjermanisë dhe Polonisë nisi në vitin 1939 me pushtimin e Polonisë nga Gjermania. Në të vërtetë problemet nisin rreth 176 vite më parë. Polonia pësoi tri ndarje të territoreve të saj në vitet: 1772, 1793 dhe 1795, ku përfituesi kryesor i territoreve më pjellore ishte shteti prusian. Do të duhej përfundimi i Luftës së Parë Botërore, që Polonia të rikthehej në hartën e kontinentit të vjetër.

Territoret që krijuan Poloninë e post-luftës u morën kryesisht nga Gjermania P.Lindore (territoret e Dancingut, Prusi Perëndimore dhe Silesi e Sipërme Perëndimore). Kjo që ndodhi në Konferencën e Versajës, qe një nga shtyllat kryesore që Adolf Hitleri përdori për të rrëzuar Republikën e Vajmarit dhe për të përgatitur kasaphanën e Luftës së Dytë Botërore. Lufta nisi me pushtimin e Polonisë më 1 shtator nga Gjermania. Në planet e Hitlerit, Polonia ishte pjesë e planit "Rechsgeu Warthelana" (Gjermania e pastër etnike). Pjesë e këtij plani ishte largimi i 15 milionë polakëve dhe sjellja e 4-5 milionë gjermanëve. Gjermanët u rezervuan hebrenjve "death camps" kampet shfarosëse, kurse për polakët u ngritën "concetration camps" (kampe pune) dhe "death camps" (kamp e skllavërisë).

Gjatë luftës vdiqën rreth 3 milionë hebrenj polake, 3 milionë të tjerë u detyruan të punojnë si skllevër, kurse 10 milionë u zhvendosën. Pas luftës, rreth 4 milionë gjermanë u shpërngulën për në Perëndim, vetëm në vitet 1945-1949. Pa harruar këtu edhe rreth 1 milion të tjerë gjatë Luftës së Ftohtë. Ripajtimi më i vështirë nuk ishte ai midis Gjermanisë dhe Francës. Në të vërtetë ka një dallim, francezët u trajtuan nga gjermanët, në fushëbetejë si të barabartë, madje me respekt nuk u ndërtua asnjë lloj kampi përqendrimi apo shfarosëse. Në krahun tjetër, Polonia u trajtua si një vend i dorës së dytë, si vendet e kolonizuara të Afrikës apo Azisë. Pra, si një komb i pacivilizuar.



Ripajtimi gjermano-polak u dëmtua ndjeshëm nga Lufta e Ftohtë, që u zhvillua fill pas Luftës II Botërore. Megjithëse pati një mori takimesh, kryesisht pas vdekjes së Stalinit në vitin 1953. Çdo gjë mori një trajtë tjetër në 7 dhjetor 1970, me Traktatin e Varshavës, ku Gjermania Perëndimore njohu si kufi vijën e lumenjve Odër-Nisse. Në vitin 1975, nisi ripajtimi i vërtetë, pasi deri atëherë kishte ngelur në letër dhe në shkëmbimet e popullsisë. Ripajtimi (reconcaliation) që në thelb nuk kishte faktin se ne jemi të barabartë, por që ne jemi të ndryshëm, por dimë të gjejmë gjuhën e përbashkët. Me gjithë dëshirën e madhe të kancelarëve të Gjermanisë, Kohl dhe Brand, përsëri nuk u arritën rezultate konkrete në pajtimin me Poloninë. Në një ambient si ai i Luftës së Ftohtë, ishte e pamundur të ndërtoheshin ura bashkëpunimi Perëndimoro-Lindore. Do pritej në fund Lufta e Ftohtë, për të parë Gjermaninë dhe Poloninë si aleate.

Së pari, ribashkimi i Gjermanisë nuk u pa si një kërcënim nga Polonia, madje u pa si një partner tregtar dhe ekonomik. Menjëherë u ngrit Zyra e Pajtimit gjermano-polak (Foundation Polish-Germany Reconciliation) me fusha veprimi kryesore:

1. Ndihma humanitare, medikamentesh për viktimat e L.II.B.
2. Dëgjimi dhe regjistrimi i dëshmive të viktimave të L.II.B.
3. Organizime të takimeve të të rinjve me viktimat e L.II.B.
4. Leksione të hapura, ekspozita dhe seminare ndërkombëtare), me fokus mësimin nga gabimet e së shkuarës. Ky fondacion financohet nga qeveria gjermane, polake, austriake dhe OSBE-ja. Ndër të tjera, Gjermania e post-luftës së Ftohtë vazhdoi të dënonte krimet e kryera gjatë L.II.B. dhe madje merrte pjesë në çdo aktivitet që flitej për këto çështje. Sot, një nga hallkat se si vazhdon ky proces është bashkëpunimi i historianëve dhe studiuesve në përgatitjen e librave të historisë për nxënësit e cikleve para-universitare. Një nga veçantitë e ripajtimit gjermano-polakë është se sot qyteti i Gorlic në kufi, ku dikur ishte qyteti që vuante më shumë se çdo qytet tjetër nga shpërnguljet dhe konfliktet, ka vetëm një tabelë që tregon nga ana vizuale kufirin mes dy shteteve.

Seminari ndërkombëtar i Krzyzowa, veç të tjerash nxori në pah edhe një detaj tjetër, atë të dramës së familjeve gjermano-polake, që duhet të zgjidhnin se kë pasaportë duhet të mbanin. Shpeshherë ndodhte që qytetet ku ata jetonin, ndryshonin, herë nën kontrollin polak, gjermanë ose rusë. Dhe çdo herë ata përballeshin me sfida nga më të ndryshmet, shpërngulje apo edhe vrasje. Kjo ishte tabloja e marrëdhënieve deri para viteve 1945. Pajtimi gjermano-polak nuk duhet parë vetëm si një histori e jashtëzakonshme, se si dy armiq të betuar, që një ditë vendosën të harronin gjithçka, e të pajtohen. Por, duhet pasur parasysh si mënyra më e mirë se si vendet e Ballkanit t'i japin fund ballkanizimit dhe dasive etnike, raciale dhe fetare me prejardhje nga shekujt e mesjetës.

Ballkani akoma vuan nga konfliktet si, ndër shtetet që vazhdojnë e përplasen janë: Greqi-Maqedoni, Serbi-Kroaci, Serbi-Bosnje, Bullgari-Maqedoni, Greqi-Turqi, Shqipëri-Maqedoni dhe Kosovë-Serbi. Një hap është hedhur, me anë të Procesit Berlinit dhe krijesës së tij të brishtë, RYCO, po që akoma nuk po jep rezultatet që priten. Mbase do duhen edhe shumë vite, që barrierat kufitare që qëndrojnë akoma në këmbë të bien mes vendeve ballkanike.





Jeton Selimi

Ish-mbrojtësi kuqezi vlerësohet nga presidenti Duka: Shembull për të rinjtë

# Cana: E ndjej për detyrë të kontribuoj për futbollin tonë

## Ish-kapiteni emërohet ambasador i "Grassroots"-it

Ish-kapiteni i Kombëtares, Lorik Cana ka dalë dje në një konferencë për shtyp në ambientet e Federatës Shqiptare të Futbollit, ku ka marrë detyrën e re si ambasador i "Grassroots"-it. "Kur jam prezent në ambientet e federatës, ndihem mirë, pasi ndihemi si një trup i vetëm, duke punuar për ngritjen e cilësisë. Gjithsecili mundohet të japë vlerat profesionale. Unë e ndiej detyrë të kontribuoj në futbollin e vendit tonë. Kur them tonë, nuk kam parasysh vetëm Shqipërinë, por edhe Kosovën. Ne si shoqëri kemi përfituar shumë nga sporti. Vitet e fundit është demonstruar se, nëse ne punojmë, mund të jemi të suksesshëm. Ne jemi një vend në zhvillim dhe futbolli ndihmon në këtë pjesë. Unë mendoj që për të pasur një pjesëmarrje të madhe nuk vjen brenda një dite. Ne në vendin tonë nuk e di a kemi pasur më parë, por unë do vazhdoj të jap stimuj, të nxit njerëzit të merren me futboll. Është një program për të marrë pjesë në futboll. Unë tani bëj pjesë te veteranët dhe kam vendosur të vazhdoj me projektet e federatës për të bindur dhe nxitur të gjithë për t'i mbajtur me frymën e sportit, për t'i dhënë shumë vlera futbollit. Nuk do jetë një detyrë e përditshme, por kërkon një punë të madhe. Me padurim pres ta filloj këtë punë. Rezultatet i presim pas disa vitesh. Në vendin tonë është e vështirë të vendosësh baza për trajnimin e fëmijëve. Ka shumë probleme, siç është infrastruktura, por jemi duke ecur përpara. Duhen njerëz që të kenë ide dhe projekte. Pse të mos e bëjmë edhe ne investimin që ka bërë Goran Pandev në Maqedoni. Duke parë marrëdhënien me presidentin, çdo lloj bashkëpunim i nevojshëm do realizohet. Në momentin që unë jam tërhequr nga futbolli, kam pasur mbështetjen e të gjithëve, madje edhe të presidentit. Do jem më i preokupuar jashtë Shqipërisë si Lorik. Besoj se do ndihmoj sa herë të jetë e nevojshme, por e shoh veten jashtë, jo këtu. Në Shqipëri po merrem me projekte, që nuk më hanë shumë kohë dhe do vazhdoj të bëj më të mirën me këtë që kam nisur", u shpreh Lorik Cana. Cana në këtë detyrë të re pati edhe përkrahjen maksimale të presidentit të federatës, Armand Duka, i cili u shpreh i bindur se figura e Lorikut do ta ndihmojë në ecurinë e këtij projekti, që ka si synim masivizimin dhe zhvillimin e futbollit te moshat e reja. "Jemi me ish-kapitenin për një event shumë të rëndësishëm, për ta emëruar ambasador të projektit 'Grassroots'. Pas ceremonisë së organizuar në Shkodër, për të gjithë kontributin e tij, ne do të vazhdonim bashkëpunimin. Është prioritet absolut për FSHF-në futbolli i fëmijëve, një projekt që do të vazhdojë. Sot duhet të mendojmë për të ardhmen dhe besoj se çdo fëmijë e ka ëndërr të bëhet i suksesshëm si Lorik Cana. E shfrytëzojmë këtë shembull pozitiv. FSHF do ta mbështesë Lorik në çdo hap që do të ndërmarrë", deklaroi Duka.




FLET SULMUESI

### Salihi: Kombëtarja po rinovohet, por unë jam gjithmonë gati



Katër gola vetëm në ndeshjen e fundit. Në total 13 gola në 15 javë të luajtura në Ligën e Parë austriake, ku është edhe golashënuesi i kampionatit. Hamdi Salihi po përjeton rininë e dytë në Austri, duke bërë atë që di më mirë, të shënojë. Bomberi po shijon momentin, pa menduar më tepër se ç'duhet për të ardhmen. "Po shkon pak ndoshta edhe jashtë parashikimeve, por ndihem mirë, sepse gjatë gjithë kësaj kohe kam punuar shumë dhe gjithçka po funksionon perfekt. Pastaj, pak rëndësi ka sa vite do të luaj, sepse këtë nuk e llogaris sa herë që bëj gol. E rëndësishme është që për sa kohë të luaj, të mos bie poshtë këtyre niveleve dhe të mos bëhem qesharak". Me shkodranin në formë të jashtëzakonshme, edhe skuadra e tij, Wiener Neustadt ëndërron rikthimin në elitën e futbollit austriak. "Mundësitë janë shumë të mëdha për t'u kthyer prej këtij viti në Bundesligë, pasi dy skuadra ngjiten direkt, ndërsa i treti shkon në play-off. Po të mbajmë këtë rritëm, besoj që do t'ia arrijmë. Është pak e vështirë, sepse Riedi dhe Insbruku janë ekipe më të organizuar dhe me më tepër traditë, por do të ishte e bukur ta arrinim këtë objektiv". Në këtë moment, Salihi është ndër sulmuesit shqiptarë më në formë. Por, kur flitet për rikthimin e mundshëm në Kombëtare, 33-vjeçari është i vetëdijshëm për realitetin, megjithatë për "SuperSport.al" shprehet gjithmonë i gatshëm për të dhënë kontributin e tij. "Kam treguar se nuk jam kursyer asnjëherë për të qenë pjesë e Kombëtares edhe kur luaja në Amerikë apo në Kinë. Kam ardhur gjithmonë me dëshirë. Çdo gjë në shërbim të ekipit Kombëtar, do të kisha qenë i gatshëm për t'u afruar apo për ta ndihmuar. Por, duhet të jemi pak realistë, vitet ecin dhe normalisht besoj se trajneri ka plane të tjera. Përtej gjendjes dhe formës momentale të lojtarëve, i duhet të bëjë edhe vlerësime afatgjata. Por, kur do të jetë nevoja, unë jam gjithmonë gati për të ndihmuar ekipin kombëtar". Sulmuesi shkodran vazhdon ta ndjekë kampionatin shqiptar, ku vlerëson se Skënderbeu do të jetë shkëputur nga rivalët për titullin prej muajit dhjetor, ndërsa nuk ka asnjë peng që këtë vit nuk është pjesë e korçarëve për të luajtur sërish në grupet e Europa League. "Kam parë disa ndeshje të Skënderbeut dhe të Vllaznisë. Skënderbeu është 100%, ashtu siç e kisha menduar. Edhe pse njerëzit mund të mendojnë se ritmi në Europë të lodh, është e kundërta. Ritmin që mban gjatë Europa Leagues e mban edhe në kampionat dhe bën diferencë me ekipet e tjera. Besoj se deri në dhjetor Skënderbeu do të jetë shkëputur nga rivalët dhe do të bëjë atë për të cilën është ndërtuar, që të shpallet kampion. Që në fushë atë ditë (ndeshja me Kukësin) e mora vendimin se koha ime në kampionatin shqiptar kishte mbaruar. Ishte e mjaftueshme ajo që kisha kaluar. Më vjen keq për gjestin dhe gjithçka, por ato janë gjëra që i takojnë së kaluarës dhe mund t'i ndodhin kujtdo. Më vjen mirë që Skënderbeu është kthyer shumë shpejt dhe ka ditur të kalojë situatat e vështira të atij fundkampionati", deklaroi Hamdi Salihi për "SuperSport.al".

SULMUESI



### Sadiku: I kalova problemet, tashmë jam ambientuar në Poloni

Dy golat e shënuar në Kupën e Polonisë e kanë ndihmuar Armando Sadikun që të kthehet përsëri vendimtar për skuadrën e Legias së Varshavës. Sulmuesi i përfaqësueses shqiptare ishte lënë në hije gjatë javëve të fundit edhe për faktin se nuk po arrinte të gjente rrugën e rrjetës. Por në takimin e Kupës ndaj Bytovia, ai shënoi 2 herë, në fillimin dhe fundin e ndeshjes, për të treguar se nuhatja para portës nuk i mungon, thjesht kishte pasur nevojë për pak më shumë kohë për t'u ambientuar me futbollin në Poloni, siç pranoi vetë pas ndeshjes. "Çdo herë unë mundohem të bëj më të mirën, punoj dhe jap 100%. Çdo ditë e më shumë ndjehem mirë në skuadër. Në fillim gjithçka ishte e re për mua dhe kisha disa probleme të vogla. Tani, me trajnerin e ri, gjithçka po shkon mirë. Jam i lumtur me golat në ndeshjen kundër Bytovia, që na ndihmuan të fitonim dhe të shohim me optimizëm drejt raundit tjetër të Kupës së Polonisë", tha futbollisti.

VLERËSIMI

### Ballotta, elozhe Strakoshës: Sillet si veteran

Së fundi Strakosha ka marrë elozhe edhe nga ish-portieri i Lacios dhe Interit, Marco Ballotta. Ky i fundit është shprehur se Strakosha ka sjellje prej veterani dhe do të jetë portieri i Lacios për 10 vitet e ardhshme. "E kam thënë edhe herë të tjera. Strakosha ka sjellje prej veterani, nëse shikon se si vendoset në portë dhe si drejton repartin e mbrojtjes. Është ende i ri dhe ndoshta do të bëjë edhe ndonjë gabim, por mund t'ju them se me të, Lacio ka gjetur portierin e duhur për të paktën 10 vitet e ardhshme", tha Ballotta.

NDESHJA E KONTROLLIT

### Partizani "ngroh motorët" në stërvitje, Basrak shënon 3 gola

Skuadra e Partizanit ka zhvilluar ditën e djeshme një ndeshje miqësore me ekipin B, në kuadër të përgatitjeve për ndeshjen e kësaj fundjave ndaj Flamurtarit. Takimi është mbyllur me shifrat e thella 6-0 për të besuarit e Iulianos, edhe pse në 45 minutat e para shënoi vetëm Shahinas. Në të dytën, Krasniqi, Trashi dhe tre golat e Basrak vulosën fatin e kësaj miqësoreje. Partizani do të zhvillojë këtë të diel, në orën 17:00, sfidën ndaj Flamurtarit, e cila gjendet një pozicion më sipër në renditje dhe ka një pikë më shumë se kryeqytetasit.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

